

Arrestohen katër persona,
u konfiskohen mbi
25 mijë euro para kesh
dhe sasi të narkotikëve



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



KOSOVA I KA NDERUAR VIKTIMAT E MASAKRËS SË REÇAKUT TË ENJTEN,
NË FSHATIN E SHTIMES, KU 27 VJET MË PARË FORCAT
SERBE I VRANË 45 CIVILË SHQIPTARË

KOSOVA PËRKUJTON REÇAKUN DHE KËRKON DREJTËSI PËR VIKTIMAT E MASAKRËS



Në 27-vjetorin e masakrës së Reçakut, liderët politikë dhe shumë qytetarë kanë bërë homazhe të enjten në Kompleksin Memorial në Reçak. Pas homazheve, ata kanë kërkuar drejtësi për viktimat e kësaj masakre, duke theksuar se Kosova nuk do të ndalet së kërkuari drejtësi. Si çdo përvjetor, edhe në këtë përvjetor ishte i pranishëm William Walker, ish-ambasadori i OSBE-së në Kosovë, i cili ishte personi i parë ndërkombëtar që vizitoi vendin e ngjarjes dhe u tmerrua kur pa kufomat e masakruara

**FILLON ZBATIMI I LIGJIT
PËR KOMUNIKACIONIN
DHE I LIGJIT PËR TË
HUAJT NË KOSOVË** F. 3



**PSE PO NDODH
RINUMËRIMI I
PJESSHËM I
VOTAVE DHE
ÇFARË MUND TË
PRITET?** F. 5



AKTUALE



**KË E PREK PEZULLIMI I VIZAVE TË
EMIGRIMIT PËR NË SHBA?** F. 2

**PRISHTINA FORCON EDUKIMIN
DIGJITAL NË SHKOLLA ME
MBËSHTETJEN E FINLANDËS,
SUEDISË DHE EEI** F. 7

**BAJRAMI KËRKON LARGIMIN E
ABDIXHIKUT, AI THOTË SE PËR
DORËHEQJEN E OFRUAR VENDOS
KUVENDI I LDK-SË** F. 6

EKONOMI



**GAP-I: KOSOVA PËRBALLET ME
DEFICIT REKORD TREGTAR DHE
VARËSI TË LARTË NGA IMPORTI** F. 8

RRITET NUMRI I FLUTURIMEVE F. 8

SPORT



**ZGJEDHJET PËR PRESIDENT TË
FSHF-SË DO TË MBAHEN MË 16
SHKURT, DUKA I VETMI KANDIDAT**

F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

KË E PREK PEZULLIMI I VIZAVE TË EMIGRIMIT PËR NË SHBA?

PRISHTINË, 15 JANAR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump, e ka bërë të qartë se të huajt që emigrojnë në ShBA duhet ta mbajnë veten me punë, dhe jo të bëhen barrë e shtetit. Prandaj, të mërkurën e 14 janarit vendosi ta pezullojë përkohësisht lëshimin e vizave të emigrimit nga 75 vende të botës, përfshirë Kosovën. Tani, Departamenti amerikan i Shtetit po e bën rishikimin e plotë të të gjitha politikave, rregulloreve dhe udhëzimeve, për t’u siguruar që emigrantët nga këto shtete - që autoritetet amerikane i cilësojnë si vende me rrezik të lartë - të mos i shfrytëzojnë ndihmat sociale të shtetit amerikan dhe të mos bëhen barrë e parasë publike. Vendimi, i cili prek edhe kosovarët që duan të aplikojnë për vizë emigrantësh, do të hyjë në fuqi më 21 janar 2026. Më poshtë mund të lexoni krejt çfarë duhet të dini për këtë çështje.

Çfarë është viza e emigrimit?
Viza e emigrimit është vizë që ia mundëson një shtetasi të huaj të hyjë në Shtetet e Bashkuara, me

qëllim që të jetojë atje përjetë. Pra, në thelb, kjo vizë është bileta që ia mundëson përfituesit të bëhet ligjërisht banor i përhershëm në SHBA. Pas hyrjes në SHBA, poseduesit të vizës i lëshohet ajo që njihet si “Green Card”, që shërben si dëshmi se mbajtësi i saj është banor i përhershëm i ligjshëm. Kjo vizë u lëshohet atyre që duan të zhvendosen përherë në SHBA, në vend se ta vizitojnë përkohësisht për turizëm, studime ose punë. Pasi i pranohet viza, personi zakonisht fiton të drejtën për të jetuar përherë në SHBA, për të punuar pa kufizime, dhe përfundimisht për të aplikuar për shtetësi amerikane.

A lejohet aplikimi për vizën e emigrimit gjatë periudhës së pezullimit?
Po. Shtetasit nga vendet e prekura nga vendimi i Trumpit mund të bëjnë kërkesë për vizë dhe mund të marrin pjesë në intervistë. Departamenti i Shtetit njoftoi se do të vazhdojë të caktojë terminë për intervista, pavarësisht se gjatë kohës së pezullimit nuk do të lëshojë viza të emigrimit për



shtetasit e 75 vendeve të prekura.

Kush nuk preket nga ky pezullim?
Shtetasit me dy shtetësi që aplikojnë me pasaportë të vlefshme të një vendi që nuk është i futur në listën e 75 vendeve të prekura nuk preken nga ky vendim. Për shembull, nga të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, vetëm Serbia nuk preket nga ky vendim.

Si ndikon pezullimi tek ata që kanë vizë të vlefshme?
Vendimi i Trumpit nuk ndikon tek ata që tashmë kanë vizë të vlefshme të emigrimit. Pra,

vendimi nuk kërkon heqjen e vizave të lëshuara paraprakisht.

A vlen vendimi për vizat turistike?
Jo. Ky vendim vlen vetëm për aplikantët për vizë të emigrimit. Vizat turistike nuk janë viza emigrimi, prandaj edhe nuk preken.

Pse e mori Trump këtë vendim?
Presidenti amerikan tha se një përqindje tejet e lartë e të huajve që janë zhvendosur në Shtetet e Bashkuara, përmes vizës së emigrimit, nuk punojnë – por varen nga ndihmat sociale amerikane. Ai nuk dëshiron që të huajt që

synojnë të emigrojnë në Shtetet e Bashkuara të bëhen barrë e parasë publike dhe ndihmave të shtetit. Për shembull, 46 për qind e shtetasve të Kosovës që kanë shkuar në ShBA përmes vizës së emigrimit marrin ndihma sociale nga Qeveria amerikane, sipas listës së publikuar nga Trump në rrjetet sociale më 4 janar. ShBA-ja i kishte lëshuar 6.674 viza emigrimi për kosovarët në 10 vjetët e fundit, apo mesatarisht rreth 670 viza në vit, sipas të dhënave të Departamentit të Shtetit. Radio Evropa e Lirë ka kontaktuar Qeverinë në detyrë të Kosovës për të marrë një koment prej saj për këtë çështje, por deri në momentin e publikimit të këtij teksti nuk ka pranuar një përgjigje. Butani i prin listës, pasi 81.4 për qind shtetasve të tij që janë zhvendosur në SHBA përmes vizës së emigrimit, jetojnë me ndihma sociale. Të dhënat zyrtare tregojnë se Shtetet e Bashkuara kishin lëshuar mbi 612.000 viza emigrimi në gjithë botën në vitin 2024, që është më shumë se në vitin paraprak (562.976).

TRUMP S’I PËRJASHTON VEPRIMET USHTARAKE, MEGJITHËSE THOTË SE IRANI I KA NDALUAR EKZEKUTIMET

UASHINGTON, 15 JANAR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, tha duke u thirrur në “burime shumë të rëndësishme nga pala tjetër” se Irani e ka pezulluar ekzekutimin e protestuesve. Por, pavarësisht kësaj, tensionet në gjithë Lindjen e Mesme vazhdojnë të jenë të larta pasi mundësia që Shtetet e Bashkuara të veprojnë ushtarakisht kundër Teheranit është ende reale. “Ata kanë thënë se i kanë ndaluar vrasjet dhe se ekzekutimet nuk do të kryhen. Pritej të kishte shumë ekzekutime sot dhe ato nuk do të ndodhin, ne do ta zbulojmë”, u tha Trump gazetarëve në Shtëpinë e Bardhë më 14 janar. “Na është thënë nga burime të besueshme dhe shpresoj që të jetë e vërtetë”, shtoi ai. Autoritetet iraniane i kanë shtypur protestat e javëve të fundit si kurrë më parë, pasi iraniane në mbarë vendin dolën në rrugë për ta ngritur zërin kundër Qeverisë, duke i sfiduar si rrallëherë sunduesit klerikal që nga Revolucioni Islamik i vitit 1979. Grupi i pavarur vëzhgues amerikan i të drejtave të njeriut, HRANA, tha se, sipas të dhënave

të tij të konfirmuara dhe të verifikuara më 14 janar, numri i të vrarëve në protesta ka arritur në 2.435 protestues, dhe se më shumë se 18.000 të tjerë janë arrestuar. Por, ai dhe burime të tjera thonë se numri i vërtetë i të vrarëve ka shumë mundësi të jetë disa herë më i lartë. Pas raportimeve se autoritetet po i shtypin dhunshëm protestuesit, Trump ka paralajmëruar disa herë se Shtetet e Bashkuara mund të ndërhyjnë për t’i ndaluar vrasjet, ndërsa u ka bërë thirrje iranianeve t’i vazhdojnë protestat. Gjatë këtyre protestave ka qenë shumë e vështirë të merren dhe të verifikohen të dhëna për gjendjen brenda Iranit, sepse autoritetet e ndërprejnë pothuajse të gjithë qasjen në internet menjëherë pas fillimit të demonstratave në fund të dhjetorit, të nxitura fillimisht nga një ekonomi e dobët dhe një monedhë në rënie të lirë. “Bllokada e internetit në Iran ka kaluar shifrën e 156 orëve, ndërsa heshtja thellohet pas një goditjeje brutale”, tha vëzhguesi NetBlocks në një postim më 15 janar. “Në të njëjtën kohë,

mungesa e të dhënave online po nxit përhapjen e llogarive proregjimit, falsifikimeve të krijuara nga inteligjenca artificiale dhe agjendave të tjera”. Grupet për të drejtat e njeriut kishin raportuar se një protestues i arrestuar, 26-vjeçari Erfan Soltani, do të ekzekutohej më 14 janar, gjashtë ditë pas arrestimit të tij nën akuzën për “luftë kundër Zotit” për rolin e tij në protesta. Trump tha më 13 janar, në një intervistë për CBS News, se nëse autoritetet do ta kryenin ekzekutimin “do të shihni disa gjëra”. Grupi për të drejtat e njeriut Hengaw, me bazë në Norvegji, duke cituar të afërmit e Soltanit, tha më 14 janar se ekzekutimi nuk kishte ndodhur, megjithëse “shqetësime serioze dhe të vazhdueshme” mbeten. Trump nuk ka sqaruar se çfarë veprimesh mund të ndërmarrin Shtetet e Bashkuara kundër Iranit dhe kur, por një pjesë e personelit amerikan është këshilluar nga Uashingtoni të largohet nga baza kryesore ajrore amerikane në rajon, pasi Teherani paralajmëroi vendet fqinje që strehojnë trupa



amerikane se do të hakmerrej ndaj bazave amerikane nëse Uashingtoni përmbush kërcënimet e tij. Faqja për gjurmimin e fluturimeve, Flightradar24, tha më 14 janar se Irani kishte lëshuar një Njoftim për Aviatorët (NOTAM), duke njoftuar mbylljen e hapësirës së tij ajrore për të gjitha fluturimet, përveç fluturimeve ndërkombëtare drejt dhe nga vendi që kishin marrë leje. NOTAM-i ishte i vlefshëm për “pak më shumë se dy orë”, tha ajo. Udhëheqja islamike e Iranit i ka përballuar protestat e mëparshme, por trazirat e

fundit vijnë në një kohë kur Teherani ende po e rimerr veten nga lufta e vitit të kaluar me Izraelin - kur Shtetet e Bashkuara iu bashkuan atij në një seri sulmesh ajrore ndaj objekteve bërthamore të Iranit. Mendohet se Trump po shqyrton mundësi që përfshijnë sulme të kufizuara ushtarake, një fushatë më të koordinuar goditjesh kundër Korpusit të Gardës Revolucionare Islamike (IRGC), ose masa joushtarake si një bllokadë e plotë ekonomike apo sulme kibernetike për të ndërprerë sistemet e komunikimit dhe vendimmarrjes së agjencive iraniane të sigurisë.

FILLON ZBATIMI I LIGJIT PËR KOMUNIKACIONIN DHE I LIGJIT PËR TË HUAJT NË KOSOVË

Në Kosovë fillon zbatimi strikt i Ligjit për komunikacionin dhe i Ligjit për të huajt. Masat do të prekin kryesisht serbët që jetojnë në Kosovë, përdorin automjete me targa serbe mbi bazën e autorizimit, ose nuk kanë dokumente kosovare. Politikanët serbë dhe organizatat joqeveritare kanë kritikuar masat dhe kanë kërkuar dialog ose shtyrje të tyre

PRISHTINË, 15 JANAR - Në Kosovë, nga sonte në mesnatë, fillon zbatimi strikt i Ligjit për komunikacionin, sipas të cilit automjetet me targa të huaja nuk mund të qarkullojnë në vend më shumë se tre muaj ose mbi bazën e autorizimit. Këtë e konfirmoi për “Radion Evropa e Lirë” zëvendësudrejtori i Policisë së Kosovës për rajonin e veriut, Veton Elshani. Njëkohësisht, nis edhe zbatimi strikt i Ligjit për të huajt sa u përket dokumenteve personale. Sipas tij, të gjithë ata që nuk posedojnë dokumente të Kosovës, do të duhet të aplikojnë për leje qëndrimi brenda 72 orëve. Këto masa do të prekin kryesisht pjesëtarët e komunitetit serb që jetojnë në Kosovë dhe që deri më tani kanë drejtuar automjete me targa të qyteteve në Serbi mbi bazën e autorizimit, ose nuk kanë pasur dokumente të Kosovës. Zbatimi pa përjashtime i këtyre dy ligjeve ishte paraparë të fillonte më 1 nëntor të vitit të kaluar, por Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës e shtyu këtë afat deri në mesnatën e 15 janarit, 2026, për të mundësuar zhvillimin e një fushate informuese. Këto masa të autoriteteve kosovare, megjithatë, po hasin në kritika nga komuniteti serb - sektori civil dhe përfaqësuesit politikë.

Si do të ndikojë Ligji për komunikacionin te komuniteti serb?

Nga Policia e Kosovës thanë për “Radion Evropa e Lirë” se drejtimi i automjeteve me targa të huaja mbi bazën e autorizimit është në kundërshtim me Ligjin për komunikacionin. Megjithatë, deri më tani, kjo praktikë është toleruar për t'u dhënë qytetarëve kohë t'i ndërrojnë targat. Veton Elshani theksoi se, nga 15 janari në mesnatë, policia do ta zbatojë ligjin në terren. Ai shtoi se drejtimi i automjeteve mbi bazën e autorizimit do të lejohet vetëm në raste emergjente, por me paralajmërim. “Për shembull, nëse dikush shkon në spital, nuk do ta ndalojmë dhe nuk do ta konfiskojmë menjëherë automjetin. Por, nëse i njëjti person ndalohet përsëri në ditët në vazhdim, mund t'i shqiptohet gjobë deri në 200 euro”, shpjegoi ai. Kosova ndaloi në fund të vitit 2022 qarkullimin e automjeteve me targa me akronimet e qyteteve të Serbisë. Kjo masë shkaktoi daljen e disa



serbëve nga institucionet e Kosovës dhe rriti tensionet në terren. Disa nga pjesëtarët e komunitetit serb që jetojnë në Kosovë, i regjistruan më pas automjetet e tyre me targa të Serbisë dhe i përdornin ato mbi bazën e autorizimit. Në këtë autorizim përfshihen të dhënat e kartës së identitetit të drejtuesit të automjetit, e cila lëshohet nga autoritetet serbe për qytetet në Kosovë, por që Prishtina zyrtare nuk e njeh.

Si do të ndikojë Ligji për të huajt te komuniteti serb?

Ligji për të huajt mund t'i prejë pjesëtarët e komunitetit serb që nuk kanë dokumente kosovare, por jetojnë, punojnë ose studiojnë në Kosovë. Megjithatë, Elshani tha se ligji nuk do të zbatohet strikt për ata që jetojnë në Kosovë dhe që për ndonjë arsye nuk kanë dokumente kosovare. “Ne nuk do t'i dëbojmë këta persona, nuk do t'i ndajmë nënat nga fëmijët apo baballarët nga fëmijët”, tha ai, duke shtuar se ligji do të zbatohet vetëm për ata që vijnë në Kosovë për turizëm, punë ose studime. “Zbatimi do të bëhet gradualisht, nuk do të dëbohet askush menjëherë. Për shembull, nëse në orën 02:00 të mëngjesit policia takon dikë në rrugë dhe ai nuk ka dokumente kosovare, ai do të njoftohet që duhet të paraqitet në stacionin policor”, shpjegoi Elshani. Në manualin “Udhëzuesi për hyrjen, lëvizjen, qëndrimin dhe punësimin e të huajve në Republikën e Kosovës”, i publikuar vitin e kaluar,

shpjegohet procedura për marrjen e lejes për “qëndrim të përkohshëm, afatshkurtër ose të përhershëm”. Vendimin për lëshimin e lejeve do ta marrë Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim i Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës. Në Mitrovicë të Veriut funksionon një universitet që punon brenda sistemit të Serbisë, ku studiojnë ose punojnë shtetas të Serbisë. Po ashtu, punonjës nga Serbia ka edhe në institucionet shëndetësore në mjediset me shumicë serbe dhe në disa institucione kulturore. Megjithatë, autoritetet e Kosovës nuk i njohin këto organe serbe dhe kanë mbyllur shumicën e tyre, përveç institucioneve arsimore dhe shëndetësore.

Reagimet e sektorit civil dhe të politikanëve

Të dhëna të sakta zyrtare se sa serbë jetojnë në Kosovë dhe posedojnë dokumente kosovare, nuk ka, pasi pjesëtarët e këtij komuniteti, kryesisht në katër komunat e veriut, e bojkotuan regjistrimin e popullsisë në vitin 2024. Megjithatë, një raport i organizatës joqeveritare Aktiv nga viti 2024, me titullin “Analiza e trendëve dhe qëndrimeve të komunitetit serb”, nxori në pah se mbi 93% e 503 të anketuarve kanë dokumente kosovare. Grupi i organizatave serbe joqeveritare ka theksuar më herët se ekzistojnë mijëra serbë të Kosovës që nuk mund të marrin dokumente kosovare, pasi “regjistrimi civil i serbëve të Kosovës, si dhe i pjesëtarëve të

tjerë të komuniteteve joshumicë, është penguar për një kohë të gjatë”. Autoritetet kosovare, në periudhën nga nëntori 2024 deri në prill 2025, u mundësuan serbëve në Kosovë ta marrin shtetësinë “më vonë”, duke pasur parasysh se disa nuk mund t'i merrnin dokumentet kosovare për shkak se posedonin vetëm dëshmi të lindjes, të lëshuara nga institucionet serbe, të cilat Prishtina nuk i njeh. Lista Serbe - partia kryesore e serbëve në Kosovë që ka mbështetjen e Beogradit zyrtar - njoftoi më 14 janar se ka zhvilluar dhjetëra takime me përfaqësues ndërkombëtarë, lidhur me zbatimin e Ligjit për komunikacionin dhe Ligjit për të huajt, duke theksuar se ka hasur në mirëkuptim, por se nuk ka marrë përgjigje ndaj kërkesave të saj. “Edhe gjatë ditëve të fundit, përfshirë edhe sot, kemi qenë në kontakt intensiv me përfaqësues ndërkombëtarë dhe kemi përcjellë shqetësimet e qytetarëve tanë, veçanërisht sa u përket pasojave të mundshme nga zbatimi eventual i këtyre vendimeve të dëmshme”, thuhet në reagim. Lista Serbe u bëri thirrje autoriteteve të Kosovës që ta shtynjë sërish zbatimin e këtyre “rregullave”, me qëllim që të gjendet një model i përshtatshëm. Edhe politikanë të tjerë serbë reagueshan për ndaj këtyre masave. Nenad Rashiq, udhëheqës i Partisë për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë, i cili fitoi një ulësë në Kuvendin e Kosovës në zgjedhjet e fundit, deklaroi më 13 janar për transmetuesin

publik kosovar se masat duhet të shtyhen përsëri, pasi “nuk jemi mjaftueshëm të përgatitur”. Lëvizja Kombëtare Serbe e Millija Bishevacit, Iniciativa Qytetare “Rrënjët” e Ivan Vučkoviçit dhe Iniciativa Qytetare “Veriu për të gjithë” e Marko Jakshiqit, iu drejtuan më 15 janar me një letër të hapur Qeverisë në detyrë të Kosovës, Bashkimit Evropian dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, duke kërkuar reagim të menjëhershëm lidhur me zbatimin e Ligjit për komunikacionin dhe Ligjit për të huajt, me arsyetimin se këto masa do t'i prekin mijëra familje. Këta përfaqësues politikë të serbëve në nivel lokal kërkuar, mes tjerash, shtyrjen e zbatimit të ligjeve të kontestuara, nisjen e dialogut me përfaqësuesit e komunitetit serb dhe komuniteteve të tjera joshumicë, si dhe gjetjen e modaliteteve të përshtatshme dhe të zbatueshme që, siç thanë, do t'u sigurojnë qytetarëve një zgjidhje të qëndrueshme dhe afatgjatë. Demokracia Serbe e Aleksandar Arsenijeviqit kërkoi që zgjidhja të gjendet përmes dialogut për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë. Nga ana tjetër, Zyra për Kosovën në Qeverinë e Serbisë i cilësoi këto masa si “hapa të rinj përshkallëzues”. Kjo zyrë paralajmëroi se, nëse Bashkimi Evropian dhe grupi i Quint-it nuk reagojnë, “Beogradi do të detyrohet të shqyrtojë një përgjigje politike dhe ligjore - adekuate ndaj këtyre shkeljeve drastike të të drejtave themelore të popullit serb përmes masave të reja të njëanshme dhe të dhunshme”.



KOSOVA I KA NDERUAR VIKTIMAT E MASAKRËS SË REÇAKUT TË ENJTEN, NË FSHATIN E SHTIMES, KU 27 VJET MË PARË FORCAT SERBE I VRANË 45 CIVILË SHQIPTARË

KOSOVA PËRKUJTON REÇAKUN DHE KËRKON DREJTËSI PËR VIKTIMAT E MASAKRËS

Në 27-vjetorin e masakrës së Reçakut, liderët politikë dhe shumë qytetarë kanë bërë homazhe të enjten në Kompleksin Memorial në Reçak. Pas homazheve, ata kanë kërkuar drejtësi për viktimat e kësaj masakre, duke theksuar se Kosova nuk do të ndalet së kërkuari drejtësi. Si çdo përvjetor, edhe në këtë përvjetor ishte i pranishëm William Walker, ish-ambasadori i OSBE-së në Kosovë, i cili ishte personi i parë ndërkombëtar që vizitoi vendin e ngjarjes dhe u tmerrua kur pa kufomat e masakruara

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 15 JANAR - Mëngjesi i 15 janarit 1999 mbetet një nga faqet më të errëta të historisë së njerëzimit. Në Reçak, forcat serbe, para syve të botës, ekzekutuan barbarisht 45 civilë shqiptarë. Burra, gra, pleq dhe të rinj të paarmatosur, u vranë

mizorisht vetëm pse ishin shqiptarë. Aty, krimi shtetëror serb u zhvesh nga çdo maskë dhe u shfaq në formën më çnjerëzore të tij. Një ditë pas kryerjes së masakrës, William Walker, ambasadori i OSBE-së në Kosovë, vizitoi vendin e ngjarjes dhe u tmerrua nga kufomat e masakruara.

Ai në atë kohë kishte deklaruar: “Nga ajo që pashë nuk ngurroj të përshkruaj ndodhinë si masakër dhe krim kundër njerëzimit. Kjo është ngjarja më trishtuese në jetën time”. Lajmi i masakrës së Reçakut senzibilizoi opinionin ndërkombëtar për krimet serbe në Kosovë dhe i hapi rrugën bombardimeve të NATO-s në

Serbi.

Në 27-vjetorin e masakrës së Reçakut, liderët politikë, ish-ambasadori William Walker dhe shumë qytetarë kanë bërë homazhe në Kompleksin Memorial në Reçak.

Pas homazheve, ata kanë kërkuar drejtësi për viktimat e kësaj masakre, duke theksuar se Kosova nuk do të ndalet së kërkuari drejtësi.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se për këtë krim dhe shumë të tjera, Serbia ende nuk është ndëshkuar. “Në këtë 27-vjetor të masakrës së Reçakut, edhe një herë kujtojmë viktimat e kësaj masakre të llahtarshme, e cila sërish dëshmoi qëllimin shfarosës që

regjimi gjenocidal i atëhershëm i Serbisë kishte ndaj popullit të Kosovës. Reçaku dhe plagët e Reçakut ende flasin, sepse dhimbja është po aq e freskët sa ishte para 27 vitesh. Dhimbja është e freskët për familjet, por është e freskët për gjithë popullin e Kosovës, sepse ende nuk ka asnjë drejtësi për krimet që janë kryer këtu, por edhe në pjesë të tjera të Republikës së Kosovës. Edhe pas 27 vitesh, Serbia vazhdon me po të njëjtat politika dhe po të njëjtën mendësi, sepse mohimi i krimit, siç po bëjnë ata me mohimin e krimit të Reçakut, është krim i dyfishtë”, ka thënë Osmani në deklaratën e saj për mediet pas homazheve.



PSE PO NDODH RINUMËRIMI I PJESSHËM I VOTAVE DHE ÇFARË MUND TË PRITET?

PRISHTINË, 15 JANAR - Dyshime për manipulime me vota, veçanërisht brenda subjekteve politike, dhe ankesa nga kandidatët për deputetë ka pasur në vazhdimësi ndër vite në Kosovë. Tani, një vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për t'i rinumëruar votat në një të tretën e vendvotimeve për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit ka ngritur shqetësime edhe për integritetin e procesit më të fundit zgjedhor.

Për më tepër, rinumërimi rrezikon ta vonojë edhe më shumë themelimin e institucioneve të reja të Kosovës, dhe mund të sjellë ndryshime në përbërjen e Kuvendit prej 120 vendesh, paralajmërojnë vëzhguesit.

Çka ndodhi dhe si erdhi deri këtu?

KQZ-ja - e cila mbikëqyr procesin zgjedhor në vend - e filloi rinumërimin më 13 janar në 914 vendvotime nga 2.557 sa ishin në zgjedhjet e dhjetorit, pasi vërejti mospërputhje në votat për kandidatët për deputetë. “Rezulton se votat e kandidatëve, të numëruara në Qendrat Komunale të Numërimit, nuk pasqyrojnë numrin e votave të kandidatëve të evidentuara në fletëvotime”, tha KQZ-ja.

Rinumërim të plotë, sipas saj, do të ketë në 10 komuna të Kosovës, ndërkaq në 28 komunat tjera do të ketë rinumërim vetëm në 10 për qind të vendvotimeve, gjatë dy javëve në vijim. KQZ-ja i hetoi 33 vendvotime të ndryshme në gjithë vendin, duke i shikuar xhirimet e kamerave të vendosura në tavolinat e numërimit në qendrat komunale të numërimit. “Vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për rinumërimin e votave ka për qëllim garantimin e saktësisë dhe integritetit të procesit zgjedhor”, thotë për “Radion Evropa e Lirë” (REL) zëdhënësi i KQZ-së, Valmir

Elezi.

Eugen Cakolli, nga Instituti Demokratik i Kosovës, thotë për “REL”-in se hetimi i KQZ-së ka shpërfaqur “mangësi serioze të votat e kandidatëve, përkatësisht manipulimet që duket se kanë ndodhur nga komisionarë të caktuar në qendrat komunale të numërimit”.


Derisa KQZ-ja në këtë fazë i cilëson këto shpërputhje vetëm si lëshime, Cakolli thotë se kjo nuk mund të sqarohet “si gabim njerëzor, por është shenjë e një manipulimi të qartë që duket se ka ndodhur”.

Sipas tij, ka kandidatë që u janë gjetur dhjetëra apo madje mijëra vota dallim nga rezultati i njoftuar dhe ai në fletëvotime në një vendvotim të vetëm, pas verifikimit që ka bërë komisioni zgjedhor. “Ta zëmë, në një vendvotim në Prizren, meqë Prizreni ka rreth 700 vota dallim pas verifikimit nga KQZ-ja, ka kandidat të cilit del se në qendrën komunale të numërimit i janë shtuar 107 vota më shumë se sa i ka pasur në të vërtetë”, thekson Cakolli.

Organizata joqeveritare Çohu ngriti shqetësime për gjetjen e mangësive të tilla, duke thënë se kjo nuk është e pazakontë në Kosovë.

Si bëhet numërimi i votave dhe si rrodhën lëshimet?

KQZ-ja i emëron grupet e numërimit në bazë të nominimeve të partive politike, sipas Ligjit për zgjedhjet. Në rastet kur subjekti politik nuk nominon anëtarë për numërim apo nominon pamjaftueshëm, apo kur numëruesit e subjekteve politike nuk paraqiten në vendin e numërimit, KQZ-ja emëron numërues nga stafi i saj. Në qendrat komunale të numërimit vendosen tavolina, në të cilat, tani me ligjin e ri nga viti 2023, përveç grupeve të numërimit, vendoset edhe një kamerë sipër për ta xhiruar çdo fletëvotim që kalon nëpër dorën



e numëruesit, e cila shfaq fletëvotimin në një ekran aty pranë. Ai ekran shërben për t'ua mundësuar vëzhguesve ta shohin dhe ta verifikojnë çdo fletëvotim.

Po ashtu, numëruesi flet me zë të lartë, në mënyrë që zyratari tjetër përgjegjës t'i fusë votat në një sistem elektronik. Përveç personit që e lexon fletëvotimin, një i dytë e merr atë dhe e verifikon.

Cakolli nënvizon se, pavarësisht ndryshimeve të reja, “nuk ka kontrolle të hollësishme” të fletëvotimeve. “Vëzhguesit, qoftë nga partitë politike, shoqëria civile apo mediat, kanë pamje vetëm në ekranin në fjalë, por jo edhe në fletëvotimin origjinal, ndonëse ka kamerë sipër saj”, thekson ai.

Sipas tij, në këto zgjedhje ka pasur “vëzhgim minimal”, pasi procesi u zhvillua në një kohë festash të fundvitit.

Pothuajse çdo proces zgjedhor ndër vite është përcjellë me parregullsi të tilla në Kosovë, dhe Çohu tha se kjo ndodh për shkak të pandëshkueshmërisë ndaj njerëzve që kanë “manipuluar me vullnetin e qytetarëve”.

Së voni, Çohu ka publikuar një hulumtim që tregon se mbi 90 për qind e rasteve për manipulimet zgjedhore përfundojnë me dënime me kusht ose me gjoba.

Sipas Cakollit, keqpërdorimet

me votat e kandidatëve janë një prej fenomeneve që e kanë karakterizuar pothuajse secilin proces zgjedhor në Kosovë, dhe ndryshimet me ligjin e ri nuk kanë sjellë përmirësime. “Tani, thjesht mundësohet që manipulimet e mundshme të ndodhin edhe më lehtë, sepse në vend se të kemi 2.500 njësi ku numërohen votat, që do të thotë se mundësia për korruptimin e ndonjë komisionari është shumë më e vogël sepse ka shumë më shumë në lojë, tani në 38 qendra mjafton që me një grup të vogël të njerëzve që punojnë nëpër këto qendra, të manipulohet rezultati zgjedhor për votat e kandidatëve”, thotë ai.

Ai shton se zgjidhja është përmes teknologjisë, pra skanimit të fletëvotimeve, të cilat pastaj, përmes një sistemi automatik, do ta paraqisnin rezultatin, duke shmangur numërimin dhe verifikimin manual.

Cilat mund të jenë pasojat?

Rinumërimi mund të sjellë ndryshime në përbërjen e re të Kuvendit, pasi shumë kandidatë që siguruan si të fundit vende në organin ligjvënës, kanë dallim shumë të vogël votash me ata që mbetën jashtë Kuvendit, sipas Cakollit.

Gjithashtu, rinumërimi, i cili

pritet të zgjasë deri në dy javë, mund ta vonojë edhe më shumë themelimin e institucioneve të reja, në një kohë kur vendi nuk ka kohë për të humbur.

Kuvendi i ri duhet të nxitojë për të kaluar marrëveshje ndërkombëtare financiare për vendin, si dhe ta zgjedhë presidentin para se Vjosa Osmanit t'i mbarojë mandati në prill.

Cakolli e vlerëson si hap të mirë vendimin e KQZ-së për rinumërimin e 36 për qind të vendvotimeve, por e konsideron të pamjaftueshëm. “Në radhë të parë, parcializimi i vendimmarrjes për rinumërim, nuk arsyetohet në asnjë variant. Pse janë zgjedhur vetëm 10 për qind, nëse ka indikacione që ka pasur gabime të tilla edhe në komunat e tjera?”, pyet ai.

Cakolli shton se KQZ-ja duhet të bëjë rinumërim të plotë, për të garantuar se zgjedhjet kishin integritet, dhe për t'i shmangur vonesat e mëtejshme.

Elezi e përsëriti për REL-in mesazhin e kryetarit të KQZ-së, Kreshnik Radoniqi, se nëse pas rinumërimit vërehen manipulime të mundshme me votat e kandidatëve brenda subjekteve politike, komisioni do t'i çojë në organet kompetente anëtarët e ekipeve të numërimit.

Cakolli thekson se autoritetet është dashur t'i fillojnë hetimet ndaj të gjithë komisionarëve të përfshirë në dyshimet për manipulim. “Prokuroria duhet që sa më parë e pa vonesa t'i fillojë hetimet, në mënyrë që shkelësit dhe keqpërdoruesit e mundshëm ta marrin dënimin e merituar, në mënyrë që kjo të shërbejë si masë parandaluese”, shton ai.

Çohu, ndërkohë, kërkoi nga institucionet e drejtësisë të hapin menjëherë hetim të pavarur dhe të plotë për çdo element të mundshëm të manipulimit apo mosrespektimit të vullnetit të qytetarëve. “Çdo dyshim për manipulim të vullnetit qytetar duhet të trajtohet me seriozitet maksimal dhe pa vonesa”, tha organizata.

Kurse, kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka treguar për ndikimin që kjo masakër ka pasur. “Para 27 vitesh, këtu nga Reçaku nëpërmjet ambasadorit Ëalker jehoi e vërteta për krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit dhe krimin e gjenocidit të Serbisë si shtet ndaj popullit shqiptar në Kosovë. Pas Masakrës së Reçakut, u ndërgjegjësuan, mobilizuan edhe opinion publik edhe kancelaritë ndërkombëtare. Lavdi 45 martirvëe të Reçakut dhe 11 dëshmorëve të udhëhequr nga komandanti Ahmet Kaçiku”, ka thënë Kurti. Hamazhe kanë bërë edhe liderët

opozitarë.

Kryetari i PDK-së, Bedri Hamza, së bashku me bashkëpartiakë ka bërë homazhe në Reçak. “Në Reçak, në përvjetorin e masakrës që tronditi botën, nderuam martirët e vrarë mizorisht nga regjimi serb. Nuk harrojmë. Nuk ndalemi. Liria e Kosovës ka emra, ka dhimbje dhe kërkon drejtësi e përgjegjësi. Lavdi të rënëve të Reçakut! Lavdi të gjithë të rënëve për lirinë e Kosovës!”, ka thënë Hamza. Kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka thënë se masakra e Reçakut u dokumentua dhe u denoncua para botës nga përfaqësuesit ndërkombëtarë,

përkatësisht ambasadori Walker, duke u cilësuar si krim kundër njerëzimit. “Ky akt tronditi opinionin ndërkombëtar dhe ndikoi drejtpërdrejt në ndërgjegjësimin global për realitetin në Kosovë. Reçaku e bëri botën ta shohë Kosovën me sy tjetër. Ishte momenti kur e vërteta nuk mund të fshihej më. Sot, pas 27 vitesh, kujtojnë me respekt të thellë viktimat e Reçakut dhe shprehin solidaritet të përhershëm me familjarët e tyre. Kjo ngjarje përbën një nga dëshmitë më të rënda të vuajtjeve që ka përjetuar populli ynë në rrugën drejt lirisë. Ruajtja e kujtesës historike, mbrojtja e

së vërtetës dhe kërkimi i drejtësisë për krimet e luftës mbeten obligim shtetëror dhe moral. Pa drejtësi për viktimat, paqja nuk mund të jetë e plotë”, ka thënë Abdixhiku pas homazheve.

Edhe kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka bërë homazhe në Reçak, duke theksuar se sot bëhen 27 vjet kur forcat serbe masakruan 45 shqiptarë të paarmatosur në Reçak.” Në nderim të dëshmorëve dhe martirëve, kam bërë homazhe në Kompleksin Përkujtimor në Reçak. Masakra e Reçakut, ashtu si edhe masakrat e tjera ndaj popullit shqiptar, janë dëshmi e

krimeve gjenocidale që aparati shtetëror serb kreu në Kosovë. Mirënjohës përjetë ambasadorit amerikan, William Walker, i cili e përkufizoi këtë masakër si krim kundër njerëzimit. Në të njëjtën kohë, falënderim i veçantë për Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që ishin dhe mbeten krah nesh në të gjitha periudhat historike”, ka thënë Haradinaj.

Në nderim të 45 viktimave të pafajshme që u vranë mizorisht 27 vjet më parë në Reçak, u mbajt akademi përkujtimore, nga ku u tha se Reçaku është dëshmia që Serbia kreu gjenocidin ndaj popullatës civile shqiptare.

DRITË MBI PLAGË: NJË MEMORIAL POETIK

Lulëzim ETEMAJ

Përmbledhja poetike “Dritë mbi plagë”, botim i Qendrës “Gjenocidi në Kosovë- Plagë e Hapur” përfaqëson një akt të vetëdijshëm poetik të kujtesës kolektive, ku fjala artistike shndërrohet në dëshmi morale për gjenocidin e kryer nga Serbia ndaj shqiptarëve gjatë luftës në Kosovë. Në Ditën e sotme të Gjenocidit dhe jo vetëm, kjo përmbledhje lexohet si një memorial letrar që refuzon harresën dhe e kthen dhimbjen në përgjegjësi shoqërore. Një nga shtyllat kryesore të librit është ndjeshmëria e thellë emocionale: poezitë shprehin



me intensitet dhimbjen, humbjen dhe mallin për të dashurit e varrë apo të zhdukur, duke i bërë këto përjetime historike të prekshme për

lexuesin. Kjo e shndërron librin në një mjet të fuqishëm komunikimi emocional për trauma kolektive, ku poezia nuk zbukuron plagën, por e

ndriçon atë për ta mbajtur gjallë në ndërgjegjen tonë dhe të gjeneratave që do të vijnë. Po aq e rëndësishme është përfshirja e gjerë e 51 poetëve, që i jep antologjisë karakter shumëzëror. Kjo shumësi perspektivash pasuron panoramën letrare të tematikës së luftës dhe shmang një narrativë të vetme, duke e bërë dhimbjen kolektive, por jo uniforme. Secili zë poetik kontribuon në ndërtimin e një kujtese të përbashkët, ku individualja dhe kombëtarja ndërthuren bukur me njëra-tjetrën. Në thelb, sprovat antologjike “Dritë mbi plagë” nuk synon vetëm të tregojë dhimbjen, por edhe të nxisë reflektim për

kujtesën dhe drejtësinë. Poezia këtu bëhet formë rezistence ndaj mohimit dhe heshtjes, duke kontribuar simbolikisht në proceset e përkujtimit dhe kërkesës për ndëshkim juridik të krimeve. Në këtë kuptim, libri i jep zë viktimës edhe përtej vargut, si pjesë e një thirrjeje më të gjerë etike dhe historike. Në kontekstin e Ditës së Gjenocidit, “Dritë mbi plagë” qëndron si dëshmi se kujtesa nuk është vetëm akt ceremonial, por proces i vazhdueshëm. Drita e poezisë nuk e shëron plagën, por e mbron atë nga errësira e harresës, dhe pikërisht këtu qëndron vlera e saj më e madhe kritike dhe njerëzore.

BAJRAMI KËRKON LARGIMIN E ABDIXHIKUT, AI THOTË SE PËR DORËHEQJEN E OFRUAR VENDOS KUVENDI I LDK-SË

PRISHTINË, 15 JANAR - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, tha se e ka ofruar dorëheqjen nga udhëheqja e partisë dhe se për të duhet të vendosë Kuvendi partiak. Ky reagim vjen pasi numri dy në parti, Hykmete Bajrami, njoftoi se gjatë mbledhjes partiake të mbajtur një ditë më parë ka kërkuar dorëheqjen e Abdixhikut nga drejtimi i partisë, për shkak të rezultetit zgjedhor dhe ka ofruar dorëheqje të parevokueshme nga posti i nënkryetares së LDK-së. “Kam marrë hapin më moral që një kryetar mund ta marrë: kam ofruar dorëheqjen time. Kam hapur rrugën për secilin që ka

pretendime. Jeni të lirë të garoni; në Kuvend e keni mundësinë. Tani vendimi nuk është më i imi, është i LDK-së”, shkroi ai. Abdixhiku tha se është thirrur Kuvendi i partisë dhe se aty do të diskutohet hapur për këtë çështje. “Aty vendosim hapur. Le ta presim Kuvendin”, tha ai, duke theksuar se nuk i ik përgjegjësisë. Hykmete Bajrami tha se kush merr “rezultate të rënda zgjedhore për LDK-në”, duhet të marrë përgjegjësi dhe t’i hapë rrugë zgjedhjeve të brendshme partiake. “Pas rezultateve të 28 dhjetorit, lidershipi dhe organet e partisë kanë humbur legjitimitetin prandaj duhet zgjedhje të brendshme. Zgjedhjet e brendshme në LDK janë të

domosdoshme dhe nga situata ku gjendemi nuk na shpëton asnjë proces tjetër”, shkroi Bajrami. Bajrami në zgjedhjet e fundit ishte e dyta në listën e LDK-së, pas kryetarit Abdixhiku, i cili e udhëheq këtë parti që nga viti 2021. Po ashtu, ajo është gruaja më e votuar për deputete në LDK. Abdixhiku, menjëherë pas publikimit të rezultateve preliminare më 28 dhjetor, deklaroi se merr përgjegjësinë për rezultatin zgjedhor, dhe po atë natë nuk e përjashtoi mundësinë e largimit nga drejtimi i partisë. LDK-ja ka shënuar rezultat të dobët në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 28



dhjetorit, dhe krahasuar me zgjedhjet e rregullta të mbajtura më 9 shkurt të vitit të kaluar. Në zgjedhjet e 9 shkurtit, LDK-ja kishte marrë 171.357 vota, ndërsa në zgjedhjet e dhjetorit, sipas rezultateve preliminare, ajo ka fituar 126.102 vota, duke u

renditur si fuqia e tretë politike në Kosovë. Zgjedhjet e 28 dhjetorit i ka fituar Lëvizja Vetëvendosje e Albin Kurtit me mbi 51 për qind të votave, ndërkaq subjekti i dytë ka dalë Partia Demokratike e Kosovës.

ARRESTOHEN KATËR PERSONA, U KONFISKOHEN MBI 25 MIJË EURO PARA KESH DHE SASI TË NARKOTIKËVE

EPOKA
ERE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 15 JANAR - Policia e Kosovës, konkretisht Drejtoria për Hetimin e Trafikimit të Narkotikëve, pas hetimeve dhe veprimeve në terren, në dy raste të ndara, ka arrestuar katër persona dhe ka konfiskuar dëshmi të ndryshme. Në rastin e parë, hetuesit e DHTN-së, pas një pune operativ-hetimor në terren, në lidhje me rastin e koduar “Pinku”, më 14 janar rreth orës 15:20, në rrugën “Xhemajl Mustafa” në Fushë-Kosovë, kanë identifikuar dhe kanë lokalizuar të dyshuarin m/k i cili ishte me veturën e tij, ku është ndaluar dhe është arrestuar në flagrancë duke bërë shitblerje të substancave narkotike ndaj të dyshuarit tjetër m/k. “Gjatë

kontrollit të personit të parë janë gjetur 2 qese të vogla të mbushura me substancë të dyshuar narkotike të llojit marihuanë me peshë: 2 gramë, ndërsa gjatë kontrollit të dyshuarit të dytë dhe veturës së tij janë gjetur: 9 qese të vogla të mbushura me pluhur ngjyrë e bardhë, e dyshuar substancë narkotike e llojit kokainë me peshë 4.9 gramë, 8 qese të vogla të mbushura me substancë të dyshuar narkotike të llojit marihuanë me peshë 12.7 gramë, para të gatshme në vlerë 475 euro që dyshohet se janë përfituar nga shitja e narkotikëve, si dhe dy telefona celularë”, ka njoftuar policia. Në lidhje me rastin është njoftuar prokurori kujdestar nga Departamenti i Krimeve të Rënda dhe në konsultim me të është kryer bastisje në shtëpinë



e të dyshuarit të parë, ku gjatë kontrollit janë gjetur dhe janë konfiskuar: një armë e shkurtër, një sasi e pluhurit të bardhë e dyshuar për narkotikë të llojit kokainë me peshë 15.8 gramë, 79 copë tableta të dyshuara për narkotikë të llojit ekstazi me peshë 37.7 gramë, një sasi e narkotikut të dyshuar të llojit kokainë ngjyrë e kuqe me peshë

2.6 gramë, një sasi e narkotikut të dyshuar të llojit marihuanë me peshë 322.9 gramë, dy peshore digjitale që shërbejnë për matje në sasi të vogla dhe qese najloni të zbrazura që shërbejnë për paketimin e narkotikëve. Të dyshuarit, pas intervistimit të tyre, me urdhër të prokurorit kujdestar, janë dërguar në mbajtje për 48 orë. Ndërkaq në rastin e dytë, më 14 janar, Drejtoria për Hetimin e Trafikimit të Narkotikëve (DHTN), përkatësisht Sektori Qendror për Hetimin e Trafikimit me Narkotikë në Prishtinë, ka realizuar operacionin policor të koduar “Dora e kapur”. Gjatë këtij operacioni policor, në rrugën “Imzot Nikprelaj”, është kapur në flagrancë i dyshuari m/k, të cilit i janë gjetur dhe sekuestruar 6 doza të lëndës narkotike të llojit heroinë, me

peshë totale 4 gramë. Më pas, gjatë kontrollit në banesën e të dyshuarit m/k janë gjetur dhe janë sekuestruar rreth 9 gramë hashash (çokollatë) dhe 18 gramë marihuanë. “Në vijim është bastisur banesa e të dyshuarit të parë, ku janë gjetur dhe janë sekuestruar: substancë narkotike e dyshuar për heroinë (52 paketime me peshë totale 14 gramë), një pushkë gjuetie me 9 fishekë, para të gatshme rreth 25,160 (njëzet e pesë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) euro, një veturë, një peshore, dy telefona mobilë si dhe prova të tjera materiale që ndërliken me veprën penale. Policia e Kosovës mbetet e përkushtuar në luftimin e trafikimit me narkotikë dhe sjelljen para drejtësisë të të gjithë kryerësve të këtyre veprave penale”, ka njoftuar Policia e Kosovës.

Prishtina forcon edukimin digjital në shkolla me mbështetjen e Finlandës, Suedisë dhe EEI

PRISHTINË, 15 JANAR - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka njoftuar se në shkollën “Xhemajl Mustafa”, bashkë me ambasadorët e Finlandës dhe Suedisë dhe partnerët e komunës nga EEI, u diskutua dhe u prezantua bashkëpunimi mes kryeqytetit, EEI, ambasadave dhe shkollave, që po i ndihmon mësimdhënësit dhe nxënësit tanë të jenë më të sigurt dhe më të përgatitur në botën digjitale. “Ky projekt u jep mësimdhënësve mjete dhe informata konkrete për: të dalluar informacionin e saktë nga dezinformimi, të përdorur internetin në mënyrë të sigurt, të ndërtuar mendim kritik tek të rinjtë. Kryeqyteti vazhdon të punojë që shkollat tona të jenë vende ku fëmijët mësojnë jo vetëm libra, por edhe si të mbrohen e të mendojnë vetë në epokën digjitale. Faleminderit miqve tanë nordikë për mbështetjen dhe besimin”, ka thënë kryetari Rama.



ZKA-ja DHE FONDACIONI JAHJAGA DISKUTOJNË PËR BASHKËPUNIM NË KUADËR TË RRJETIT TË GRAVE NË SEKTORIN E SIGURISË



PRISHTINË, 15 JANAR - Auditorja e përgjithshme, Vlora Spanca, së bashku me ndihmësauditoren e përgjithshme, Emine Fazliu dhe drejtoreshën e Departamentit për Komunikim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar, Qendresa Mulaj, priten në takim përfaqësuesit e projektit “Promovimi i përfshirjes së komunitetit, siguria publike dhe fuqizimi i grave për një sektor të qëndrueshëm të sigurisë në Kosovë” (MATRA). Projekti përkahehet nga

Qeveria e Holandës dhe zbatohet nga BIRN, Fondacioni Jahjaga dhe Instituti Prevent. Projekti MATRA, i prezantuar nga përfaqësuesit, Rozafa Ukimeraj, Skënder Presteshi dhe Alba Cikaqi, ka për qëllim krijimin e Rrjetit të Grave në Sektorin e Sigurisë, me fokus takimet e rregullta ndër-institucionale, shkëmbim përvojash profesionale si dhe zhvillimin e programeve të mentorimit dhe trajnimit. Auditorja e përgjithshme Vlora

Spanca i njoftoi mysafirët për angazhimin e ZKA-së në fuqizimin e grave dhe rritjen e përgjegjshmërisë së institucioneve publike përmes procesit të auditimit. Spanca dhe Ukimeraj shqyrtuan mundësitë e bashkëpunimit, përfshirë ofrimin e ekspertizës së ZKA-së për nevojat e projektit, ndonëse ZKA nuk është institucion i drejtpërdrejtë i sektorit të sigurisë, si dhe angazhimin në trajnime dhe këshilldhënie për gratë.

BOTOHEN DY LIBRA NË SHËNIM TË 15 JANARIT



PRISHTINË, 15 JANAR - Në Ditën e Përkujtimit të Viktimave të Gjenocidit në Kosovë, Qendra “Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur” ka botuar dy vepra letrare: Romanin “Revolta e Syzifit”, i autorit Bardhyl Mahmuti, që i kushtohet aktit gjenocidal në Poklek të Vjetër, gjatë së cilit forcat e armatosura serbe vranë 53 civilë shqiptarë (26 fëmijë të mitur, 5 të rinj, 20 gra dhe dy burra) dhe ribotimin e

përmbledhjes me poezi “Ëndërr në Zarf”, i autorit Ismail Sylja, që i kushtohet viktimave të gjenocidit serb në Kosovë dhe sidomos fëmijëve, ëndrrat e së cilëve mbeten në zarfe të përgjakura. Qendra “Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur” ka falënderuar donatorët, falë mbështetjes financiare të së cilëve kemi mundur të realizojmë projektet për sensibilizimin e opinionit rreth domosdoshmërisë së

mobilizimit të gjithanshëm për të hedhur dritë të plotë në krimin e gjenocidit që përjetuam gjatë luftës 1998 - 1999. Qendra “Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur” vendosi që tërësia e mjeteve financiare që do të grumbullohen nga shitja e romanit “Revolta e Syzifit” të shkojë për mirëmbajtjen e “Shtëpisë Muze - Masakra e Pokleku” dhe përkthimin e këtij romani në gjuhët e huaja.



BALLKANI NË FOKUS TË PRODUCENTËVE NDËRKOMBËTARË TË FILMIT

PRISHTINË, 15 JANAR - Ministri i Kulturës, Hajrulla Çeku, së bashku me drejtoreshën e QKK-së, Blerta Zeqiri, kanë pritur në takim disa producentë ndërkombëtarë, të cilët po shqyrtojnë Ballkanin si rajon për xhirimet e projekteve të tyre të ardhshme filmike. Gjatë takimit, ministri Çeku i ka njoftuar ata me politikën e Kosovës në fushën e kinematografisë, përfshirë Ligjin e ri të Kinematografisë, të drejtën

në rabat, lehtësitë për prodhime ndërkombëtare dhe potencialin që vendi ynë ofron për xhirime filmike. Vizita e tyre në Kosovë përfshiu edhe takime rrjetëzimi, me qëllim krijimin e kontakteve dhe bashkëpunimeve konkrete ndërmjet producentëve ndërkombëtarë dhe atyre vendorë, duke hapur rrugë të reja për zhvillimin e industrisë filmike në Kosovë.

Peci: Do të rrënohen ndërtimet pa leje dhe do të lirohen pronat e uzurpuara në Mitrovicë

MITROVICË, 15 JANAR - Kryetari i Komunës së Mitrovicës së Jugut, Faton Peci, ka paralajmëruar masa ndaj ndërtimeve dhe veprimeve që bien ndesh me ligjin, përmes një postimi publik drejtuar

qytetarëve në rrjetin social “Facebook”. Sipas tij, objektet e ndërtuara pa leje ndërtimore në këtë komunë, do të rrënohen, ndërsa lejet që janë dhënë në mënyrë kundërligjshme,

përfshirë ato gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, do të revokohen. Po ashtu, Peci ka bërë me dije se pronat komunale të uzurpuara do të lirohen. Te dashur qytetarë. Objektet e

ndërtuara pa leje do të rrënohen; Lejet ndërtimore të dhëna kundërligjshëm gjatë fushatës, po edhe të tjera, do të revokohen; Pronat komunale të uzurpuara do të lirohen”, ka shkruar kryetari Peci.



Rritet numri i fluturimeve

PRISHTINË, 15 JANAR - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar statistikën e transportit dhe telekomunikimit për muajin nëntor 2025. Në muajin nëntor 2025, numri i fluturimeve të realizuara ishte 1,055 ose 6,0 % më shumë sesa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa numri i udhëtarëve në total ishte 336 499 ose 8,1 % më shumë sesa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (nëntor 2024).

Në muajin nëntor 2025, numri i udhëtarëve ishte 7 331 ose 32,7 % më shumë sesa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa mallra të transportuar përmes hekurudhës nuk kishte në këtë muaj. Në muajin nëntor 2025, numri i përdoruesve në rrjetin e telefonisë fikse ishte 67 721 ose 11 përdorues me pak krahasuar me nëntor 2024. Ndërsa, trafiku i realizuar (në minuta) ishte 1 906 147 ose (-

10,5%) më i ulët, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Në muajin nëntor 2025, numri i përdoruesve me parapagim (Prepaid) ishte 1 506 639 ose 0,91 % më shumë sesa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa numri i përdoruesve me kontratë

(Postpaid) ishte 316 194 mijë ose 1,33 % më shumë sesa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.



GUVERNATORI I BQK-së FALËNDERON JAPONINË PËR MBËSHTETJEN NË FORCIMIN E SISTEMIT FINANCIAR DHE INTEGRIMET EVROPIANE TË KOSOVËS

PRISHTINË, 15 JANAR - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, me bashkëpunëtorët e tij, ka pritur në takim të ngarkuarin me punë të Ambasadës së Japonisë në Kosovë, Hiroyasu Tanigaki. Gjatë diskutimit, guvernatori Ismaili e njoftoi Tanigakin për zhvillimet kryesore dhe reformat në sektorin financiar, avancimin e kornizës ligjore dhe rregullative, duke theksuar stabilitetin dhe performancën e mirë të sektorit financiar. U veçuan nismat ligjore në sektorin financiar dhe aktivitetet që lidhen me gjithëpërfshirjen financiare dhe qasjen në financa dhe edukimi financiar. Në hyrje të takimit, guvernatori Ismaili e informoi të ngarkuarin me punë të Ambasadës së Japonisë në Kosovë mbi organizimin, funksionimin dhe fushëveprimin e BQK-së si



institucion i pavarur kushtetues, kapacitetet institucionale, si dhe bashkëpunimin e shkëlqyer me institucionet financiare ndërkombëtare, bankat

qendrore dhe autoritetet rregullatore e mbikëqyrëse të rajonit dhe vendeve evropiane. Me tej, ai informoi atë lidhur me ambientin e përshtatshëm të

investimeve në sektorin financiar, si dhe sektorët tjerë atraktiv të vendit. Më pas, ai e njoftoi Tanigakin me arritjet kryesore të Kosovës në

vitet e fundit si dhe avancimin në integrimin financiar përmes iniciativës për anëtarësim në SEPA dhe projektit për pagesat e shpejta (TIPS Clone), të cilat përveç kontributit direkt në ekonominë e vendit, afrojnë vendin më pranë infrastrukturës financiare evropiane. Guvernatori Ismaili shprehu mirënjohjen e BQK-së për institucionet e Japonisë, të cilat vazhdojnë të mbështesin institucionet tona, me theks atyre për forcimin e sistemit financiar të Republikës së Kosovës si dhe integritetin financiar evropian. Në përfundim, palët rikonfirmuan përkushtimin për të thelluar bashkëpunimin në mbështetje të avancimit të kornizës drejt standardeve më të larta si dhe të procesit të integritetit të Kosovës në mekanizmat relevantë ndërkombëtar.

GAP-i: KOSOVA PËRBALLET ME DEFICIT REKORD TREGTAR DHE VARËSI TË LARTË NGA IMPORTI

PRISHTINË, 15 JANAR - Sipas Institutit GAP të dhënat tregojnë se Kosova ka një varësi shumë të lartë nga importi, duke e renditur ndër vendet me raportin më të pafavorshëm import-eksport në Evropë. Sipas këtij instituti, deficitin tregtar është thelluar ndjeshëm, veçanërisht pas vitit 2020, duke arritur nivele rekord në vitet e fundit. "Ky trend reflekton kapacitete të kufizuara prodhuese dhe konkurruese, si dhe varësi të madhe nga mallrat e huaja, çka e bën ekonominë më të ndjeshme ndaj goditjeve të jashtme", ka njoftuar Instituti

GAP. Analiza e periudhës 2015 - 2025 tregon se importet janë rritur në mënyrë të vazhdueshme, duke arritur në rreth 7 miliardë euro në vitin 2025, ndërsa eksportet kanë mbetur në nivele dukshëm më të ulëta, nën 1 miliardë euro. Si rezultat, deficitin tregtar është thelluar ndjeshëm, duke arritur një nivel rekord prej rreth 6.1 miliardë euro në vitin e fundit. Thellimi i deficitit pas vitit 2020 vërehet si një prirje shqetësuese, e cila reflekton kapacitete të kufizuara prodhuese dhe konkurruese, si dhe varësi të madhe nga mallrat e importuara.

Në periudhën janar - tetor 2025, raporti import - eksport i Kosovës ishte rreth 7.8 euro import për çdo 1 euro eksport, dukshëm më i pafavorshëm krahasuar me vendet e rajonit dhe Bashkimin Evropian. Kjo e bën ekonominë e vendit më të ekspozuar ndaj goditjeve të jashtme, përfshirë rritjen e çmimeve dhe paqëndrueshmërinë në tregjet ndërkombëtare. Instituti GAP vlerëson se kjo situatë nxjerr në pah nevojën për politikë zhvillimore më aktive, rritje të prodhimit vendor, mbështetje për eksportuesit dhe



tërheqje të investimeve në sektorë me vlerë të shtuar, në mënyrë që të frenohet thellimi i

mëtejshmë i deficitit tregtar dhe të sigurohet zhvillim ekonomik i qëndrueshëm.

Më shumë thëngjill u prodhua në nëntor 2025 sesa në nëntor 2024

PRISHTINË, 15 JANAR - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar statistikën e energjisë për muajin nëntor 2025 me të dhëna për prodhimin dhe konsumin e thëngjillit, prodhimin dhe konsumin e energjisë, importin dhe eksportin e

energjisë, si dhe importin dhe eksportin e energjentëve të tjerë. Gjatë muajit nëntor të vitit 2025, energjia elektrike bruto në dispozicion ishte 634.84 GWh, kurse konsumi i energjisë elektrike ishte 509.47 GWh ose 0,39 % më i madh,

krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak. Pjesëmarrja e energjisë elektrike alternative në kuadër të konsumit të përgjithshëm ishte 12,14 %. Importi i energjisë elektrike në nëntor të vitit 2025 ishte 325.04 GWh, kurse eksporti i energjisë

elektrike në të njëjtën periudhë ishte 247.29 GWh (këtu është e përfshirë edhe sasia e transimionit). Prodhimi i thëngjillit për muajin nëntor 2025 ishte rreth 663 413 mijë ton që paraqet një rritje prej 2,94 %, krahasuar me muajin e njëjtë të vitit të kaluar.



SA LARG DO TË SHKOJË EUROPA PËR TË MBROJTUR GROENLANDËN NGA TRUMPI?

Kërcënimi i Donald Trumpit për të marrë nën kontroll Groenlandën “një mënyrë apo një tjetër” ka shkaktuar tronditje në fuqinë sovraane të tij Danimarkën, ndërsa pjesa tjetër e Europës është duke kërkuar me ngut mënyra për ta ndalur.



Katherine BUTLER

Kërcënimi i Donald Trumpit për të marrë nën kontroll Groenlandën “një mënyrë apo një tjetër” ka shkaktuar tronditje në fuqinë sovraane të tij Danimarkën, ndërsa pjesa tjetër e Europës është duke kërkuar me ngut mënyra për ta ndalur. Pas tronditjes që shkaktoi sulmi ushtarak i SHBA-së ndaj Venezuelës, ambicia e Trumpit për ta pasur Groenlandën si objektivin e radhës nuk shihet më në Europë si mburrje apo fantazi, por si një qëllim serioz, i nxitur nga ideologjia, neo-imperializmi, etja e SHBA-së për minerale kritike, ose nga të gjitha këto së bashku. Mospërfillja e hapur e Trumpit ndaj të drejtës ndërkombëtare po nxjerr sërish në pah dilemën e dhimbshme që buron nga varësia paralizuese e Europës nga SHBA për sigurinë ushtarake: a duhet ta përballin apo ta zbusin, edhe kur veprimet prej “shteti të çmendur” pasqyrojnë pushtimin rus të Ukrainës, të cilin ata e konsiderojnë të paligjshëm? Menjëherë pas sulmit ndaj Venezuelës, i cili u shoqërua me një heshtje shurdhuese nga Europa, këshilltari i Trumpit, Stephen Miller, u mburr në një intervistë për CNN se “askush nuk do të luftojë me Shtetet e Bashkuara” për Groenlandën. A ka të drejtë Miller? Ditët e fundit është vërejtur një ndryshim toni. Udhëheqësit e gjashtë fuqive europiane, Franca, Gjermania, Spanja, Italia, Polonia dhe Mbretëria e

Bashkuar, nxorën një deklaratë të rrallë të përbashkët, duke riafirmuar mbështetjen e tyre për sovranitetin danez dhe duke i dërguar në thelb një paralajmërim Trumpit, që të mbajë duart larg Groenlandës. Groenlanda i përket popullit të saj, thanë ata: “Vetëm Danimarka dhe Groenlanda duhet të vendosin mbi çështjet që kanë të bëjnë me Danimarkën dhe Groenlandën”. Por se çfarë lloj “luftime” janë të gatshme të ndërmarrin këto fuqi europiane për Groenlandën, nëse diplomacia dështon, mbetet e paqartë. Në një takim në Uashington, Danimarka po përpiquej ta çtensiononte krizën me premtime sigurie, duke këmbëngulur se Groenlanda nuk është në shitje. Shumë groenlandezë kanë ndjenja të përziera ndaj Danimarkës për shkak të trashëgimisë koloniale, por për momentin të dy qeveritë janë në një linjë. Zëvendëspresidenti amerikan, JD Vance, pritej të ringjallte ide më tipike të shekullit të 19-të, si “blerja” e shkëputjes së territorit. Justifikimi i Trumpit për kërcënime ndaj një aleati besnik të NATO-s, gjoja për ta mbrojtur Groenlandën nga një agresion i mundshëm i ardhshëm rus apo kinez, nuk qëndron, thonë analistët. Shqetësimet e sigurisë së SHBA-së mund të adresohen pa aneksuar Groenlandën. Groenlanda është një territor gjysmëautonom që nga viti 1979, por si pjesë e Danimarkës mbrohet nga NATO. Trump mund të kërkojë që aleatët e NATO-s të forcojnë mbrojtjen e


kufijve të jashtëm të këtij territori strategjik. Traktatet ekzistuese të epokës së Luftës së Ftohtë mes Danimarkës dhe SHBA-së për mbrojtjen e përbashkët të Groenlandës i japin Uashingtonit dorë të lirë për të dislokuar më shumë trupa. Ai mund të rihapë 16 nga 17 bazat ushtarake amerikane që kishin operuar më parë, por që më pas i kishte mbyllur.

Një modus vivendi?

Teksa alarmi rritet në Danimarkë dhe në vetë Groenlandën, – prej ku raportimet përshkruajnë një atmosferë frike, me shumë njerëz që pyesin veten nëse duhet të largohen, mund të shohim Mbretërinë e Bashkuar të luajë një rol më aktiv për të zbutur krizën. Qeveria e Keir Starmerit shpreson të ndërmjetësojë një modus vivendi me Uashingtonin. Pasi mbajti një profil të ulët për Venezuelën, Starmer shpreson se shqetësimet amerikane për sigurinë e gjithë rajonit Arktik mund të adresohen brenda traktateve ekzistuese, duke qetësuar njëkohësisht frikën daneze për “pronësinë”. Starmer dhe Trump kanë folur dy herë gjatë javës së fundit për të bërë më shumë për të mbrojtur “verin e lartë” nga një inkursion i mundshëm rus. “Qëndrimi në Londër është se ka një marrëveshje të mundshme për Groenlandën,” tha Patrick. “Vështirësia me këtë administratë amerikane, megjithatë, është të identifikosh

saktësisht se cilat janë motivet e presidentit kur flet për ‘pronësinë’.” “Groenlanda duket se ka një cilësi pothuajse mistike për Trumpin, por a do të thotë kjo se ai thjesht dëshiron të jetë në gjendje të tregojë me gisht në hartën e SHBA-së dhe të thotë se territori i saj është zgjeruar duke përfshirë Groenlandën? Kjo mbetet e paqartë.” Starmer ka dërguar sekretaren e jashtme, Yvette Cooper, në Finlandë dhe Norvegji. Përpara vizitës së saj, ajo nuk përmendi drejtpërdrejt Groenlandën apo nevojën për t’u përballur me kërcënimet e Trumpit, por i bëri thirrje “NATO-s të intensifikojë punën e saj në Arktik për të mbrojtur interesat euro-atlantike në rajon”. Deklarata e Cooper shtoi gjithashtu: “Me ndryshimet klimatike që hapin Arktikun, rajoni do të bëhet një front gjithnjë e më kritik për NATO-n.” “Duke iu referuar ndryshimeve klimatike, shkrirjes së akullit arktik dhe rrjedhimisht rritjes së kërcënimit të paraqitur nga Rusia,” thotë Patrick, “Mbretëria e Bashkuar po pranon vlefshmërinë e shqetësimeve të Trumpit, por sigurisht jo zgjidhjen e tij, pra pushtimin amerikan.” Megjithatë, me Trumpin që duket i gatshëm të shkatërrojë NATO-n për hir të kontrollit të Groenlandës, pavarësisht motiveve të tij, opsionet e Europës duken të mbushura me rrezik. Por ka edhe karta strategjike që Europa mund të luajë. Robert Habeck, ish-zëvendëskancelari i

Gjermanisë, argumentoi në Guardian të hënën se Europa duhet të shfaqë pak nga machtpolitik-a e saj (politika e forcës) dhe t’i ofrojë Groenlandës një rikthim në anëtarësimin në BE, së bashku me një paketë masive investimesh, për t’u mbrojtur nga kërcënimet amerikane. Groenlanda u largua nga Komunitetet Europiane në vitin 1985, për të rifituar kontrollin mbi peshkimin. Por nëse BE-ja do të barazonte grantin vjetor të Danimarkës me miliarda investime të reja, llogaritë mund të ndryshonin në një botë të transformuar rrënjësisht. Fabian Zuleeg, drejtor ekzekutiv i Qendrës së Politikave Europiane në Bruksel, tha se Europa, nëse qëndron e bashkuar, mund t’i tregojë Trumpit se shtrengimi i tij grabitqar ka një kosto. Ai theksoi se Europa duhet të ndërmarrë “jo gjeste simbolike, por masa që rezonojnë brenda SHBA-së dhe e dëmtojnë Trumpin dhe zgjedhjet e tij politike aty ku ka më shumë rëndësi: tek baza e tij elektorale. Tregtia, qasja në tregje, bashkëpunimi rregullator dhe partneritetet industriale ofrojnë të gjitha leva presioni.” Për analistin me bazë në Paris, Alexander Hurst, kursi më i mirë i veprimit për Europën është të detyrojë “një çarje” me SHBA-në, përfshirë edhe kërkesën që SHBA të largojë bazat e saj ushtarake nga Europa. “Gjithçka, përveç luftimit të drejtpërdrejtë, duhet të merret në konsideratë,” shkroi Hurst. / The Guardian – Bota.al



Zgjedhjet për president të FShF-së do të mbahen më 16 shkurt, Duka i vetmi kandidat

TIRANË, 15 JANAR - Komiteti Ekzekutiv i Federatës Shqiptare të Futbollit (FShF), ka zhvilluar mbledhjen e parë për vitin 2026, nën drejtimin e presidentit Armand Duka. Një nga pikat kryesore të

rendit të ditës ishte organizimi i Asamblesë së përgjithshme të zakonshme zgjedhore të FShF-së. Në përputhje me statutin, Komiteti Ekzekutiv ka vendosur që Asambleja të mbahet më 16 shkurt 2026, në

orën 10:00, në ambientet e "Shtëpisë së Futbollit". Gjatë punimeve të kësaj asambleje pritet të zgjedhen presidenti dhe anëtarët e Komitetit Ekzekutiv të FShF-së për mandatin katërvjeçar. I vetmi

kandidat për president të FShF-së është Armand Duka. Nga viti 2002, FShF-ja udhëhiqet nga Armand Duka. Ai ka fituar besimin e delegatëve të FShF-së edhe pesë herë tjera.



INCIDENTET NË BASKETBOLL, FBK-ja PARALAJMËRON MASA DRASTIKE

PRISHTINË, 15 JANAR - Pak ditë pas reagimit ndaj incidentit në Prizren, Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK), ka reaguar edhe për incidentin që ka ndodhur në Gjakovë, të mërkurën mbrëma. FBK-ja, ka shprehur shqetësim të thellë dhe ka dënuar fuqishëm incidentin e rëndë të ndodhur në ndeshjen e ndërmjet Vëllaznimit dhe Bashkimit. Gjithçka ka nisur në çerekun e dytë në palestrën "Shani Nushi", ku sipas raportit zyrtar të delegatit të ndeshjes, në çerekun e dytë janë dëgjuar ofendime në kor nga tribuna në drejtim të klubit mysafir, përçarë i është dhënë vërejtje zyrtare publikut. Me përfundimin e pjesës së parë, një grup tifozësh të skuadrës vendase ka tentuar të sulmojë persona të pranishëm në tribunë, duke krijuar rrezik serioz për përshkallëzim të situatës, dhe

thuhet se falë ndërhyrjes së menjëhershme të Policisë së Kosovës, është parandaluar një incident edhe më i rëndë. Në të njëjtën kohë, nga tribuna e ballkonit është hedhur një shishe plastike e mbushur me ujë, e cila ka goditur ndihmës-trajnerin e KB Bashkimi, Bledar Gjeqaj, në fytyrë, duke e rrëzuar atë në parket. Pas këtij akti të drejtpërdrejtë dhune dhe tentimit për sulm fizik, në koordinim me gjyqtarët e ndeshjes dhe Policinë e Kosovës, është marrë vendim për zbrazjen e palestrës nga publiku, me përjashtim të zonës VIP, me qëllim garantimin e sigurisë së të gjithë akterëve të ndeshjes. "Ky incident vjen vetëm pak ditë pas një rasti tjetër serioz dhune në basketbollin kosovar, për të cilin Federata kishte reaguar publikisht dhe kishte



paralajmëruar zero tolerancë ndaj çdo forme dhune dhe sjelljeje të papranueshme në palestra. Për fat të keq, përsëritja e incidenteve në një periudhë kaq të shkurtër tregon se situata ka marrë përmasa alarmante dhe kërkon reagim të menjëhershëm dhe të vendosur institucional", është thënë në reagimin e FBK-së.

FBK-ja ka thënë se posedon

pamjet filmike të incidentit, ndërsa Policia e Kosovës ka konfirmuar se dy persona janë arrestuar për tentim-sulm, ndërsa personi që ka hedhur shishen është identifikuar dhe priten veprime të mëtejme ligjore ndaj tij.

Njëkohësisht, KB Vëllaznimi do të ndëshkohet për organizim të dobët të ndeshjes, ndërsa do të ketë edhe masa të rënda

disiplinore, në përputhje me aktet normative dhe rregulloret e Federatës së Basketbollit të Kosovës. "Federata e Basketbollit e Kosovës thekson qartë se dhuna fizike, tentimet për sulm, fyerjet dhe çdo formë tjetër e sjelljes së papranueshme nuk do të tolerohen në asnjë rrethanë", ka njoftuar FBK-ja. Në fund, FBK-ja ka bërë me dije se përsëritja e incidenteve të kësaj natyre do të sjellë masa edhe më drastike, përfshirë mbylljen e palestrave, zhvillimin e ndeshjeve pa publik, humbjen e ndeshjeve me rezultat zyrtar dhe referimin e rasteve tek institucionet kompetente. "Basketbolli nuk do të tolerojë dhunën. Federata e Basketbollit e Kosovës do të veprojë me vendosmëri të plotë për të mbrojtur sigurinë, integritetin dhe dinjitetin e garave të saj", është thënë në reagimin e FBK-së.

BEKË BERISHA ZGJEDHET KRYETAR I KB PRISHTINA

PRISHTINË, 15 JANAR - Deputeti i zgjedhur i AAK-së, Bekë Berisha është zgjedhur kryetar i KB Prishtinës, pas mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit Zgjedhor. KB Prishtina ka njoftuar se Kuvendi është zhvilluar në përputhje me Statutin e klubit dhe me prezencën e shumicës së delegatëve të Kuvendit, pas kërkesës së tifo grupit "Plisat". Në njoftim është thënë se fillimisht është votuar për dorëheqjen e kryetarit aktual, Blerand Stavileci, e pastaj shumicë absolute votash



është propozuar dhe votuar Bekë Berisha për kryetar të ri të klubit. "Z. Bekë Berisha, një emër i njohur dhe me kontribut të rëndësishëm në fusha të ndryshme në mbarë vendin dhe në kryeqytet, e pranoi detyrën me përgjegjësi të plotë, duke premtuar se klubi më i trofeshëm në vend do të rikthejë primatin e tij si në garat vendore ashtu edhe në ato ndërkombëtare", ka njoftuar KB Prishtina. Zgjedhja e Berishës në këtë pozitë ka ngjallur reagimin e tifo-grupit "Plisat" të cilët nuk janë pajtuar me këtë vendim.

MAROKU - SENEGALI, FINALJA E KUPËS SË AFRIKËS

RABAT, 15 JANAR - Maroku dhe Senegali do të luajnë të dielën e 18 janarit finalen e Kupës së Afrikës. Kombëtarja e Marokut ka arritur në finale pasi ka mposhtur Nigerinë me penallti (4-2). 120 minuta lojë kanë përfunduar pa gola dhe gjithçka është vendosur nga pika e bardhë. Ndërsa Senegali ka mposhtur Egjiptin me rezultat 1-0, ku hero i ndeshjes ka qenë Sadio Mane, i cili ka shënuar gol në minutën e '78 të ndeshjes. Një ditë para finales, të shtunën,



Nigeria dhe Egjipti do të luajnë për vendin e tretë në kuadër të Kupës së Afrikës.

FIFA: Mbi 500 milionë kërkesa për bileta për ndeshjet e Botërorit

ZURICH, 15 JANAR - FIFA ka njoftuar se ka pranuar më shumë se 500 milionë kërkesa për bileta për Kupën e Botës të këtij viti. Organizata botërore e futbollit ka theksuar se jashtë vendeve pritëse të Shteteve të Bashkuara, Meksikës dhe

Kanadasë, kërkesat më të shumta kanë ardhur nga tifozët në Gjermani, Angli, Brazil, Spanjë, Portugali, Argjentinë dhe Kolumbi.

Pas kritikave të ashpra për çmimet e larta të biletave, FIFA ka njoftuar muajin e kaluar se

do të ofrojë bileta me një çmim prej 60 dollarësh për çdo ndeshje për 48 shoqatat kombëtare pjesëmarrëse në turne, me shoqatat që do të vendosnin se si t'i shpërndanin ato tek tifozët e tyre që kishin parë ndeshjet e tyre të

mëparshme.

FIFA ka theksuar se do t'i njoftojë aplikantët për biletat jo më herët se më 5 shkurt dhe se biletat për ndeshjet ku kërkesa tejkalon kapacitetin e disponueshëm do të ndahen me përzgjedhje të rastësishme.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 5, 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 01/2024 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare , lidhur me nenin 27.3 Rregullores (ZKA) 03/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës; Punës (ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (ZKA) Nr. 03/2025), Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2025 si dhe Vendimit të Auditorës së Përgjithshme me Nr.33 për plotësimin e vendit të lirë të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit rishpall:

KONKURS

për plotësimin e vendit të lirë të punës

1. Pozita:

Auditor Senior për auditim të performancës

Numri i referencës:

RASAP/ZKA/12-14/25

Grada:

ZKA-Z2

Numri i pozitave:

Dy (2)

Kohëzgjatja e emërimit:

Me kohë të pacaktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kryen auditime sipas planit vjetor, rregullave dhe metodologjisë së ZKA-së, Kodit të Etikës dhe në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe raporton Drejtorit të Departamentit të Auditimit dhe udhëheqësit të ekipit të auditimit;
- Në mënyrë efektive koordinon punën e auditimit me Udhëheqësin e ekipit dhe ofron mbështetje profesionale në ekip dhe në departament;
- Kryen hulumtime dhe analizë për fushën të caktuar dhe bën propozimin e temave audituese për planifikimin strategjik dhe atë vjetor të ZKA-së;
- Pjesëmarrje aktive në parastudim të auditimit, duke përfshirë përshkrimin e fushës, problem/min/motivin e auditimit, hartimin e objektivës, pyetjeve audituese, kritereve të auditimit dhe metodologjisë;
- Përpilimi i anketave/pyetësorëve lidhur me temën audituese (në rast se janë të zbatueshme për auditimin e caktuar);
- Kryerja e detyrave me përgjegjësi, të caktuara nga UE dhe Drejtori i departamentit;
- Raportimi i vazhdueshëm të mbikëqyrësi lidhur me progresin e arritur në auditim;
- Ofron përkrahje profesionale duke kryer hulumtime dhe analiza të të dhënave të mbledhura dhe prezantimin e tyre;
- Nxjerrja konkluzioneve dhe dhënia e rekomandimeve duke u mbështetur në dëshmitë audituese dhe në bazë të gjykimit profesional;
- Përgatitja e Letrave të punës dhe memos përmbledhëse audituese për pyetje me kohë me të gjitha elementet e gjetjes lidhur me auditimin e komponentës apo fushës audituese, e cila i është caktuar dhe krijon dosjen/dëshmitë e auditimit, bënë indeksimin e tyre dhe ndihmon në arkivim sipas kërkesave të UE dhe ZKA;
- Ofron mbështetje aktive për UE në shkrimin/hartimin e draft raportit dhe në proceset e rishikimit (zbatimin e komenteve), në finalizimin e raportit të auditimit dhe aktivitetet pas raportuese si dhe merr pjesë në prezantime dhe seminare ndërlidhur me atë raport;
- Komunikon mirë brenda ekipit dhe në entitet, kryen në mënyrë cilësore detyrat e përcaktuara nga UE dhe koordinohet në fazat e procesit auditues (planifikim, ekzekutim dhe raportim) dhe merr pjesë aktive në takime, intervista dhe diskutime me entitetin;
- Aplikimi i punës online sipas kërkesave dhe udhëzimeve në nivel të zyrës për situata të caktuara dhe kryerja e prezantimeve publike nëse kërkohet;
- Azhuron njohuritë profesionale dhe teknike përmes trajnimeve dhe Edukimit të Vazhdueshëm Profesional si dhe tregon gatishmëri për të zhvilluar vetveten në fushat e dakorduara me UE apo Drejtorin gjatë vlerësimit të performancës;
- Kryen edhe detyra të tjera profesionale që mund të kërkohen nga UE dhe Drejtori i departamentit.

Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, në auditimet e performancës janë:

- Arsimimi: Diplomë fakulteti në ekonomi, juridik, administratë publike, shkencë politike, shëndetësi, komunikimit ose inxhinierisë;
- Përvoja profesionale: Pesë (5) vjet përvojë pune profesionale në auditim, hulumtim apo analiza, prej tyre së paku tre (3) vjet në auditim të performancës apo të pajtueshmërisë si dhe të ketë përvojë pune në udhëheqjen e dy (2) auditimeve të performancës apo 2 auditimeve të pajtueshmërisë;
- Certifikimi: Të jetë i certifikuar për auditorë të jashtëm, certifikim ndërkombëtar apo vendor në fushën e auditimit të performancës;
- Preferohet njohuri e gjuhës angleze.

Shkathtësitë e kërkuara:

- Njohuri shkëlqyeshme në fushën e auditimeve;
- Shkathtësi në menaxhim dhe organizim të punës audituese;
- Njohuri të akteve juridike të aplikueshme në Zyrën Kombëtare të Auditimit;
- Njohuri për mbikëqyrje efektive të punës profesionale;
- Aftësi për të përfaqësuar dhe mbrojtur interesat e institucionit dhe integritetin e tij;
- Aftësi motivuese, dhe komunikuese në ekip;
- Të posedoj aftësi të mira ndër-personale.

Informata të përgjithshme për kandidatë:

Përcaktimi i pagës bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Procedura e Aplikimit:

Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:

- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore (Diplomë fakulteti). Diplomati e fituara jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara;
- certifikatë për auditor të jashtëm, certifikim ndërkombëtar apo vendor në fushën e auditimit të performancës;
- dëshmitë për përvojën e punës (Kontratë Pune ose Vërtetim i Marrëdhënies së punës, të shoqëruara me dëshmi nga Trusti);
- dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (nëse aplikohet);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen. Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (online) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data 31.01.2026 ora 16.00.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. “Ahmet Krasniqi” nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

Shënim:

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

U prilog çlanu 15.2 Zakona Br. 05/L-055 za Generalnog Revizora i Nacionalnu Kancelariju Revizije Republike Kosovo, kao i članova 5, 6 i 7 Uredbe (NKR) 01/2024 o Prijemu i Karijeri u Nacionalnoj Kancelariji Revizije u vezi sa čl. 29.3 Uredbe (NKR) 03/2024 o Klasifikaciji Radnih Mesta; (izmenjena i dopunjena Uredbom (NKR) Br. 03/2025), Godišnjeg Plana Zapošljavanja za 2025. godinu kao i Odluku Generalne Revizorke pod Nr. 33 za popunjavanje upražnjenog radnog mesta, Nacionalna Kancelarija Revizije ponovo objavljuje:

KONKURS

za popunu slobodnog radnog mesta

1. Pozicija:

Senior Revizor za reviziju učinka

Referentni broj:

RASAP/NKR/12-14/25

Rang:

NKR-Z2

Broj pozicija:

Dva (2)

Trajanje imenovanja:

Na neodređeno vreme

Dužnosti i odgovornosti:

- Vrši revizije u skladu sa godišnjim planom, pravilima i metodologijom NKR, Etičkim kodeksom i u skladu sa Međunarodnim standardima revizije i izveštava Direktora Sektora za reviziju i vođu revizorskog tima;
- Efikasno koordinira revizorski rad sa Vođom tima i pruža profesionalnu podršku timu i odeljenju;
- Vrši istraživanje i analizu za zadatu oblast i predlaže teme revizije za strateško i godišnje planiranje NKR-a;
- Aktivno učestvuje u pred-studijama revizije, uključujući opis oblasti, problem/motiv revizije, izradu ciljeva, revizorskih pitanja, kriterijuma revizije i metodologije;
- Izrada anketa/upitnika u vezi sa revizorskom temom (ukoliko su primenljivi za konkretnu reviziju);
- Obavljanje odgovornih zadataka koje dodeljuju VT i Direktor odeljenja;
- Kontinuirano izveštavanje nadređenog o postignutom napretku u reviziji;
- Pruža stručnu podršku kroz istraživanje i analizu prikupljenih podataka i njihovu prezentaciju;
- Donošenje zaključaka i davanje preporuka na osnovu revizorskih dokaza i na osnovu profesionalnog prosuđivanja;
- Priprema radnih dokumenata i zbirnih revizorskih memoranduma za pojedinačna pitanja, sa svim elementima nalaza u vezi sa revizijom komponente ili revizorske oblasti koja mu/joj je dodeljena, formira revizorski dosije/dokaze, vrši njihovo indeksiranje i pomaže u arhiviranju u skladu sa zahtevima VT i NKR-a;
- Pruža aktivnu podršku VT u pisanju/izradi nacrtu revizorskog izveštaja i u procesima revizije (primena komentara), u finalizaciji revizorskog izveštaja i post-revizorskim aktivnostima, kao i učestvuje u prezentacijama i seminarima u vezi sa tim izveštajem;
- Efikasno komunicira unutar tima i sa revidiranim entitetom, kvalitetno izvršava zadatke koje dodeljuje VT i koordinira se u fazama revizorskog procesa (planiranje, izvršenje i izveštavanje), te aktivno učestvuje na sastancima, intervjuima i diskusijama sa entitetom;
- Primenjivanje onlajn rada prema zahtevima i uputstvima na nivou kancelarije za određene situacije ao i sprovođenje javnih prezentacija ukoliko se to zahteva;
- Azurira profesionalna i tehnička znanja kroz obuke i Kontinuirano profesionalno obrazovanje, kao i pokazuje spremnost za lični razvoj u oblastima dogovorenim sa VT ili Direktorom tokom procene učinka;
- Obavlja i druge profesionalne poslove koje zahteva VT i Direktor Odeljenja.

Opšti formalni uslovi za ovo radno mesto, u reviziji učinka, su:

- Obrazovanje: Diploma fakulteta ekonomije, prava, javne administracije, političkih nauka, zdravstva ili inženjeringa.
- Profesionalno iskustvo: Pet (5) godina profesionalnog radnog iskustva u reviziji, istraživanju ili analizi, od čega najmanje tri (3) godine u reviziji učinka ili reviziji usklađenosti, kao i iskustvo u vođenju najmanje dve (2) revizije učinka ili dve (2) revizije usklađenosti;
- Sertifikacija: Da bude sertifikovan za eksterni revizor, međunarodni ili lokalni sertifikat u oblasti revizije učinka;
- Poželjno je poznavanje engleskog jezika.

Potrebne veštine:

- Istaknuto znanje iz oblasti revizije;
- Veština u organizovanju rada i ispunjavanju ciljeva;
- Poznavanje pravnih akata koji se primenjuju u Nacionalnoj Kancelariji Revizije;
- Poznavanje efektivnog nadzora nad stručnim radom;
- Sposobnost zastupanja i zaštite interesa institucije i njenog integriteta;
- Motivacione i komunikacione veštine u timu;
- Poseduje dobre međuljudske veštine.

Opšte informacije za kandidate:

Određivanje plate vrši se u skladu sa važećim zakonima.

Postupak prijave:

Postupak prijave je otvoren za sve kandidate koji ispunjavaju kriterijume konkursa. Nacionalna Kancelarija Revizije nudi jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Kosova i kandidatima iz svih zajednica na Kosovu.

Kandidati trebaju dostaviti potrebnu dokumentaciju, i to:

- službeni obrazac NKR za prijavu;
- kopiju lične karte Republike Kosovo;
- dokaz o školskoj spremi (Fakultetska diploma). Diplome stečene van Kosova moraju biti nostrifikovane;
- sertifikat eksternog revizora, međunarodna ili lokalna sertifikacija u oblasti revizije učinka;
- dokaz o radnom iskustvu (Ugovor o radu ili Potvrda o radnom odnosu, uz dokaz iz Trusta);
- potvrda iz suda da nije pravosnažno osuđivan (ne starije od šest meseci);
- dokaz da ne postoji disciplinska mera za razrešenje sa javne funkcije (ako se primenjuje);

U obzir će se uzeti samo zvanični obrazac za prijavu. Dokumenti dostavljeni nakon roka neće se razmatrati, a nepotpuni će biti odbijeni. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume. Konkurs je otvoren 15 dana od dana objavljivanja u elektronskim medijima (online) i na internet stranici Nacionalne Kancelarije Revizije. Zadnji rok za predaju dokumentacije je dana 31.01.2026 u 16.00 časova. Obrasci za prijavu mogu se dobiti na recepciji NKR-a, ili se mogu preuzeti sa web stranice NKR-a na adresi www.zka-rks.org i predati Odeljenju za administraciju dokumenata na adresi: Naselje: Arberia, ul. "Ahmet Krasniqi" br. 210 – Priština, svakog radnog dana od 08:00 – 16:00 časova, obrazac i prateća dokumentacija se mogu dostaviti i putem imejla na adresu rekrutimi@oagks.org ili putem pošte. Za detaljnije informacije možete nas kontaktirati na tel. 038/606-004, lokal 1025.

Napomena:

Prijave poslate poštom, koje nose poštanski pečat o pošiljci poslatoj poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se važećim i biće razmatrane.



Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 5, 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 01/2024 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit, lidhur me nenin 38 të Rregullores (ZKA) 03/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës (ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (ZKA) Nr. 03/2025), Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2025 si dhe Vendimit të Auditorës së Përgjithshme me Nr.33 për plotësimin e vendit të lirë të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit rishpall:

KONKURS
për plotësimin e vendit të lirë të punës

- | | |
|-------------------------|----------------------------------|
| 1. Pozita: | Zyrtar për Komunikim me Publikun |
| Numri i referencës: | RZKP/ZKA/12-15/25 |
| Grada: | ZKA-X6 |
| Numri i pozitave: | Një (1) |
| Kohëzgjatja e emërimit: | Me kohë të pacaktuar |

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ofron përkrahje profesionale në fushën e komunikimit dhe bashkëpunimit me palët e interesit;
- Ndihmon në përgatitjen e propozimeve dhe hartimin e planeve të komunikimit me palët e interesit;
- Ndihmon në përgatitjet e konferencave për media, njoftime për shtyp, deklarata dhe raporte për media;
- Ndihmon në përgatitjen dhe koordinimin e takimeve dhe forumeve me shoqërinë civile për marrjen e inputeve të jashtme lidhur me auditimin;
- Përditëson faqen elektronike zyrtare të ZKA-së;
- Përgatit njoftimet dhe informacionin e nevojshëm për nevoja të lajmeve dhe komunikimit me publikun për pjesëmarrjen e ZKA-së në aktivitetet e organizuara nga palët e interesit dhe aktivitetet ndërkombëtare;
- Monitoron dhe përcjell mediat lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me ZKA-në;
- Koordinon kërkesat nga palët e interesit dhe përgatitë raporte për angazhimin e ZKA-së në këto aktivitete;
- Bashkëpunon me të gjitha njësitë tjera organizative të ZKA-së për çështje reprezentative që kanë të bëjnë me promovimin e punës së ZKA-së.
- Kryen detyra tjera të ngarkuara nga Drejtori i departamentit

Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:

- Arsimimi: Diplomë fakulteti në shkencat shoqërore, gazetari ose komunikim masiv.
- Përvoja profesionale: Tre (3) vite përvojë pune profesionale në gazetari apo komunikim.
- Preferohet njohuri të gjuhës angleze.

Shkathësitë e kërkuara:

- Njohuri dhe përvojë në fushën e gazetarisë dhe komunikimit publik;
- Shkathësi në komunikim dhe planifikim të punës;
- Shkathësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi për përmbyllje të detyrave dhe punëve sipas afateve;
- Shkathësi kompjuterike dhe të përdorimit të aplikacioneve dhe programeve si dhe platformave dixhitale për komunikim (Word, Excel, Power Point, Access, Internetit, wordpress, uebfaqe, rrjete sociale etj.).

Informata të përgjithshme për kandidatë:

Përcaktimi i pagës bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Procedura e Aplikimit:

Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:

- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore (Diplomë fakulteti). Diplomat e fituara jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara;
- dëshmitë për përvojën e punës (Kontratë Pune ose Vërtetim i Marrëdhënies së punës, të shoqëruara me dëshmi nga Trusti);
- dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (nëse aplikohet);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen. Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (online) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data **31.01.2026 ora 16.00**.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollëshme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

Shënim:

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

U skladu sa članom 15.2 Zakona br. 05/L-055 o generalnom revizoru i Nacionalnoj kancelariji revizije Republike Kosovo, kao i članovima 5, 6 i 7 Pravilnika (NKR) 01/2024 o prijemu i karijeri u Nacionalnoj kancelariji revizije, u vezi sa članom 38 Pravilnika (NKR) 03/2024 o klasifikaciji radnih mesta (izmenjeno i dopunjeno Pravilnikom (NKR) br. 03/2025), Godišnjim planom zapošljavanja za 2025. godinu i Odlukom generalne revizorke br. 33 o popunjavanju slobodnog radnog mesta, Nacionalna kancelarija revizije ponovo objavljuje:

KONKURS
za popunjavanje slobodnog radnog mesta

- | | |
|----------------------|---------------------------------------|
| 1. Pozicija: | Službenik za komunikacije sa javnošću |
| Referentni broj: | RZKP/ZKA/12-15/25 |
| Rang: | ZKA-X6 |
| Broj pozicija: | Jedna (1) |
| Trajanje imenovanja: | Na neodređeno vreme |

Dužnosti i odgovornosti:

- Pruža stručnu podršku u oblasti komunikacije i saradnje sa zainteresovanim stranama;
- Pomaže u pripremi predloga i izradi planova komunikacije sa zainteresovanim stranama;
- Pomaže u pripremama konferencije za medije, saopštenja za štampu, izjave i medijski izveštaji;
- Pomaže u pripremi i koordinaciji sastanaka i foruma sa civilnim društvom kako bi se dobili doprinosi spolja u vezi sa revizijom;
- Ažurira zvaničnu veb stranicu NKR-a;
- Priprema saopštenja i informacije neophodne za potrebe vesti i komunikacije sa javnošću u vezi sa učešćem NKR-a u aktivnostima koje organizuju zainteresovane strane i međunarodnim aktivnostima;
- Prati i nadgleda medije u vezi sa pitanjima vezanim za NKR;
- Koordinira zahteve zainteresovanih strana i priprema izveštaje o angažovanju NKR-a u ovim aktivnostima;
- Sarađuje sa svim ostalim organizacionim jedinicama NKR-a o reprezentativnim pitanjima koja se odnose na promovisanju rada NKR-a.
- Obavlja i druge poslove koje mu dodeli direktor odeljenja

Opšte formalne kvalifikacije za ovu poziciju su:

- Obrazovanje: Fakultetska diploma društvenih nauka, novinarstva ili masovne komunikacije
- Profesionalno iskustvo: Tri (3) godine profesionalnog radnog iskustva u novinarstvu ili komunikaciji
- Poželjno je znanje engleskog jezika.

Potrebne veštine :

- Znanje i iskustvo u oblasti novinarstva i javne komunikacije;
- Veštine komunikacije i planiranja posla;
- Istraživačke, analitičke, ocenjujuće veštine i formulisanje preporuka i stručnih saveta;
- Sposobnost ispunjavanja zadataka i posla prema rokovima;
- Poznavanje rada na računaru i korišćenje aplikacija i programa, kao i digitalnih platformi za komunikaciju (Word, Excel, Power Point, Access, internet, WordPress, veb stranice, društvene mreže itd.).

Opšte informacije za kandidate:

Određivanje plate se vrši u skladu sa važećim zakonskim propisima.

Postupak prijave:

Postupak prijavljivanja je otvoren za sve kandidate koji ispunjavaju kriterijume konkursa. Nacionalna kancelarija revizije nudi jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Kosova i pozdravlja kandidate iz svih zajednica na Kosovu.

Kandidati moraju da dostave potrebnu dokumentaciju, kao nadole:


- službeni obrazac za prijavu NKR-a;
- kopija lične karte Republike Kosovo;
- dokaz o obrazovnoj spremi (diploma fakulteta). Diplome stečene van Kosova moraju biti nostrifikovane;
- dokaz o radnom iskustvu (Ugovor o radu ili Potvrda o radnom odnosu, uz dokaz iz Trusta);
- dokaz iz suda da nije pravosnažno osuđivan (ne stariji od šest meseci);
- dokaz da ne postoji disciplinska mera za razrešenje sa položaja javnog službenika (ako je primenljivo);

Samo službeni obrazac za prijavu će biti uzet u obzir. Dokumenti podneti nakon roka neće biti razmatrani, a nepotpuni će biti odbijeni. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume. Konkurs je otvoren 15 dana od dana objavljivanja u elektronskim medijima (online) i na veb stranici Nacionalne kancelarije revizije. Rok za podnošenje dokumentacije je **31.01.2026. u 16:00 časova**.

Obrasci za prijavu mogu se dobiti na recepciji NKR-a, ili se mogu preuzeti sa veb stranice NKR-a na www.zka-rks.org i dostaviti Odeljenju za upravljanje dokumentima na adresu: Naselje: Arberia, ul. „Ahmet Krasniqi“ br. 210 – Priština, svakog radnog dana od 08:00 – 16:00 časova, obrazac i prateća dokumentacija mogu se dostaviti i putem e-pošte na rekrutimi@oagks.org ili preko pošte. Za detaljnije informacije možete kontaktirati tel. br. 038/606-004, lok. 1025.

Napomena:

Prijave poslate poštom, koje nose poštanski žig o pošiljci dostavljeno poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se važećim i biće uzete u razmatranje.



Në mbështetje të nenit 8, neni 10 nën par. 2.2 dhe neni 15 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.12.2010, lidhur me nenin 7 dhe 12 par. 2 të Udhëzimit Administrativ MFPT - Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik i cili është pjesë e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i cili është i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 31.10.2017, dhe nenin 20, nenin 22 dhe nenin 28 të Rregullores Nr. 055/2025 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të N.P.L “Eko Natyra” Sh.A. e miratuar me datë 16.06.2025 nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L “Eko Natyra” Sh.A. Duke u bazuar në vendimin me nr. të protokollit **007/2026** të datës **14.01.2026** të Kryshefit Ekzekutiv, N.P.L “Eko Natyra” Sh.A. me datë **14.01.2026** shpall:

KONKURS PUBLIK I JASHTËM

- I. Titulli:** Zyrtar për Media
Numri i ekzekutuesve: 1
Orët e punës: 40 orë në javë
Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.
Përgatitja profesionale: Përgatitje universitare
Përvoja e punës: Një (1) vit
I raporton: Kryeshefit Ekzekutiv
Koeficienti i pagës: 470.00 Euro Bruto

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Harton dhe zbaton strategjinë e komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun.
- Bashkëpunon me menaxhmentin për të përçar mesazhet kryesore të organizatës.
- Krijon dhe zhvillon fushata informuese dhe promovuese.
- Mbështet dhe koordinon marrëdhëniet me mediat lokale dhe ndërkombëtare.
- Përgatit dhe shpërndan njoftime për media, deklarata publike dhe përgjigje për pyetjet e gazetarëve.
- Organizon konferenca për shtyp dhe ngjarje mediatike.
- Për punën e vet i përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv.
- Monitoron dhe analizon të dhënat nga mediat sociale për të optimizuar strategjinë e komunikimit.

➤ Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L “Eko Natyra” Sh. A - Skenderaj. (E skanuar);
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (E skanuar);
- Ekstraktin e lindjes; (Certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Certifikatën mbi dënimin penal të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, se nuk ka dënime penale në evidencën qendrore penale të Republikës së Kosovës (Certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohen);
- Dëshmitë për përvojën e punës (të skanuara) duke i bashkëngjitur CV);
- Kopjen e letërnjoftimit (E skanuar);

➤ **Kriteret e përgjithshme që duhet t'i plotësojnë të gjithë kandidatët.**

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
- Të ketë zotësi të plotë veprimi.
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare në pajtim me Ligjin për Gjuhët.

➤ **Mënyra e vlerësimit të kandidatëve.**

- Intervista me gojë deri në shtatëdhjetë (70) pikë
- Jetë përshkrimi (CV) i kandidatit deri në tridhjetë (30) pikë.

➤ Dokumentet që kërkohet para themelimit të marrëdhënies së punës:

- Vërtetimi për zotësinë e plotë të veprimit.
- Certifikatën shëndetësore.

➤ Periudha e aplikimit të kandidatëve dhe kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit.

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga dita e publikimit të të njëjtit. Shpallja është e hapur nga data **14.01.2026** deri me datë **28.01.2026** në ora **16:00**.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

- Verifikimi paraprak i aplikacioneve të kandidatëve më së largu deri me datë **04.02.2026**.
- Afati për ankesë nga data **05.02.2026** deri me datë **09.02.2026**.
- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen testit me gojë, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë **20.02.2026**.
- Afati për ankesë nga data **21.02.2026** deri me datë **23.02.2026**.
- Publikimi i rezultateve përfundimtare në lidhje me kandidatin e suksesshëm është më së largu **03.03.2026**.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit mund të zgjasë apo të jetë më i shkurtër, varësisht nga ajo se a parashtrohet ankesë apo jo, dhe varësisht nga puna e Komisionit Vlerësues dhe Departamentit të Personelit. Në të gjitha rastet kur parashtrohet ankesë në çdo fazë të procedurës së rekrutimit, ankesa do të ketë efekt suspensiv (pezullues), derisa e njëjta të shqyrtohet nga Komisioni i Ankesave.

➤ **Mënyra e aplikimit dhe komunikimi me kandidatët**

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin në Zyrën e Arkivës të N.P.L “Eko Natyra” Sh. A në qytetin e Skenderajtë, rr. “Ali Gashi” p.n, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00.

Departamenti i Personelit, duke zbatuar nenin 8 par. 3 të Udhëzimit MFPT-Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, do t'u ofrojë sqarime të nevojshme kandidatëve në lidhje me kriteret e konkursit publik, dhe do t'u asistojë dhe t'u japë udhëzimet e nevojshme për aplikim me anë të adresës elektronike.

Dorëzimi i aplikacionit me gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë shpallje publike duhet të bëhet vetëm me anë të adresës elektronike si në vijim: ekonatyra.zbnj@gmail.com.

I gjithë komunikimi gjatë procedurave të konkursit publik do të zhvillohet nëpërmjet komunikimit elektronik, dhe secili nga kandidatët do të njoftohet individualisht.

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.

➤ **Sqarim**

Ndërmarrja ka për qëllim të sqarojë çështjen e termeve të përdorura në aspektin gjinor, meqë rast fjalët dhe titujt e një gjinie përfshijnë edhe gjininë tjetër.

➤ **Përfundim**

N.P.L. "Eko Natyra" Sh. A në Skënderaj ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, dhe inkurajohen komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuara, dhe gjinia më pak e përfaqësuar që të aplikojnë.




Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë





www.facebook.com/gjejpuneshejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Ermbotelladaora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L